

# **ICLS** **2015** **Konferencë Shkencore Ndërkombëtare**

Organizatorë:

Fakulteti Juridik, Kolegji AAB, Prishtinë

Fakulteti për Kriminalistikë, Kriminologji e Studime të Sigurisë,  
Universiteti i Sarajevës, Sarajevë

## **Libri i Abstrakteve**

30 Tetor 2015 @ Kolegji AAB  
Prishtinë - Republika e Kosovës

## **Përmbajtja**

<i>Dekriminalizimi i prostitucionit dhe si faktor i jashtëm a do të ndikonte në ngritjen apo uljen e trafikimit me qenie njerëzore, prostitucion</i>	
Mensut Ademi, Ersin Sylejmani.....	7
<b>KORPORATIVNA SIGURNOST U REGIJI ZAPADNOG BALKANA</b>	
Jasmin AHIĆ .....	8
<b>ADMINISTRATA DHE POLITIKA</b>	
Avni Alidemaj .....	9
<i>Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës</i>	
Kadri Arifi .....	10
<i>Përdorimi i termit ndjekje penale dhe hetim të krimit apo “ndërmarrjes së përbashkët kriminale”</i>	
Mentor AVDYLI.....	11
<i>Drogat dhe efektet e drogave</i>	
Doc. dr. Qebir AVZIU.....	12
<i>Veprat penale krim kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare në Kosovë 1998-99</i>	
Arsim Beka.....	13
<i>Tregtia e lirë dhe efektiviteti i saj në zinxhir të vlerës të produkteve ushqimore në Kosovë</i>	
Isak Berbatovci.....	14
<i>Evolimi i të drejtës penale në lidhje me mbrojtjen e shoqërisë nga vepra “Kontrabandimi i narkotikeve” në territorin e Kosovës</i>	
Avdi BERISHA .....	15
<i>Etiologjia dhe rëndësia e saj në shpjegimin dhe ndriçimin e rrugëve të cilat shpien deri te kriminaliteti</i>	
Fidair BERISHA .....	16
<i>Roli dhe rëndësia e gjurmëve kriminalistike në zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit</i>	
Fadil Berisha.....	17
<i>Crna Gora i vladavina prava</i>	
Djordjije Blažic .....	18

<i>Studije samoprijavljivanja u detekciji prestupništva mladih - upotrebna vrijednost u socijalnoj kriminalnoj prevenciji</i>	
Muhamed Budimlić .....	19
<i>Risitë e rregullimit ligjor dhe organizimit të Shërbimit Korrektues në Kosovë</i>	
Vilard BYTYQI.....	20
<i>Besueshmëria e institucioneve publike në tranzicionin e Evropës Juglindore</i>	
Jonida Jorgu.....	21
<i>Ankesat dhe parashtrësat lidhur me procesin zgjedhor-nevoja për ndryshim</i>	
Florian Dushi .....	22
<i>Partitë politike dhe sundimi i ligjit në Kosovë</i>	
Artan Fejzullahu, Luz Balaj.....	23
<i>Funksionimi i sistemit të sigurisë në Kosovë dhe rreziku nga krimi i organizuar dhe terrorizmi</i>	
Hajdar Hoti .....	24
<i>Lëndë e konfliktit administrativ</i>	
Xhemazie Ibraimi .....	25
<i>Bashkëpunimi në mes të shërbimeve inteligjente dhe policisë në parandalimin e terrorizmit</i>	
Ganimete Ismajli, Fatmir Qollakaj .....	26
<i>Nocioni i regjimit pasuror në marrëdhëniet bashkëshortore sipas legjislacionit shqiptar</i>	
Xhensila KADI.....	27
<i>Politikëbërja në një shtet multietnik - rasti i Maqedonisë</i>	
Besa KADRIU .....	28
<i>Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm – organizimi i shtetit ligjor në luftën kundër këtyre dukurive</i>	
Ejup KAMBERAJ .....	29
<i>Tapitë e perandorisë osmane - bazë e njohjes së pronësisë në Kosovë</i>	
Muhamet Kelmendi .....	30

<i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, aktualiteti dhe rrezikshmëria</i>	
Fatmire Krasniqi.....	31
<i>Kriza e refugjatëve në Evropë dhe respektimi i të drejtave të refugjatëve</i>	
Dukagjin LEKA.....	32
<i>Politika e fqinjësisë së mirë në ballkan dhe perspektiva e Shqipërisë</i>	
Anjeza LIÇENJI.....	33
<i>Dinamika e përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit në Kosovë 2011-2014</i>	
Hazir LUSHAJ .....	34
<i>Sistemi elektoral në Republikën e Maqedonisë</i>	
Mersim Maksuti.....	35
<i>Problemet e procesit të provuarit të veprave penale të vrasjeve në Komunën e Gjilanit për periudhën kohore 1999-2014</i>	
Reshat Maliqi.....	36
<i>Alkoolizimi si problem social patologjik në rajonin e komunës së Gjilanit - Kosovë</i>	
Ahmet MALOKU.....	38
<i>Funksionimi i shtetit juridik në Evropën Juglindore me theks të posaçëm në shtetin e Kosovës</i>	
Tush Markaj.....	39
<i>Terrorizmi ndërkombëtar dhe korniza juridike për luftimin e terrorizmit sot</i>	
Samedin Mehmeti, Fatmir Qollakaj .....	40
<i>Interpretimi i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ, në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, në rastet e ankimuara nga shtetasit shqiptarë</i>	
Ilda Mucmataj.....	41
<i>Djeca u fokusu kriminoloških istraživanja</i>	
Elmedin Muratbegović .....	42
<i>Marrëveshjet paqësore dhe të drejtat e njeriut: rasti i Maqedonisë</i>	
Ali MUSLIU.....	44
<i>Pranimi i përgjegjësisë penale të personave juridikë në vendet e Evropës Juglindore - zgjedhja e ligjvënësit në Kosovë</i>	
Avni PUKA .....	45

<i>Ndryshimet e Ligjit të Procedurës penale të Republikës së Maqedonisë dhe roli i tyre në funksionimin e shtetit juridik</i>	
Vedije Ratkoceri, Blerta Arifi .....	46
<i>Osnovne karakteristike prestupništva mladih na području grada Prizrena</i>	
Ferdi Redzeqi.....	47
<i>Fenomeni i vetvrasjes ne regjionin e Ferizait</i>	
Qazim Reka .....	49
<i>Terrorizmi si kërcënim ndaj rëndit evropian dhe atij global</i>	
Fatmir RRAHMANAJ.....	50
<i>Aspekte të gjykimit pilot në çështjet e pronësisë: rasti i Shqipërisë</i>	
Nadia RUSI .....	51
<i>Nevoja për unifikim dhe harmonizim të së drejtës kontraktuese ndërkombëtare</i>	
Faton Shabani .....	52
<i>Drejtësia elektorale në Kosovë</i>	
Xhavit Shala .....	53
<i>Shqyrtimi krahasimor i analizës statistikore për refuzimin e kallëzimeve penale në Republikën e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe Hercegovinë</i>	
Marijan Šuperina, Driton Muharemi, Nedžad Korajlić .....	54
<i>Migrimi i pa rregullt në Kosovë 2009-2013</i>	
Rrahman SYLEJMANI .....	55
<i>E drejta për kthim e popullsisë shqiptare në Greqi nën hijen e legjislacionit grek dhe të së drejtës ndërkombëtare</i>	
Mentor Tahiri.....	56
<i>Mjetet edukative të nxënësve në shkollë, në veçanti mjetet e motivimit dhe ndikimi i tyre në parandalimin e sjelljes së dhunshme në shkollë</i>	
Bujar THAQI.....	57
<i>Gjenerata e tretë e të Drejtave të Njeriut në Kosovë dhe diksriminimi pozitiv</i>	
Bashkim Rrahmani, Majlinda Belegu, Veton Vula .....	58



# **Dekriminalizimi i prostitucionit dhe si faktor i jashtëm a do të ndikonte në ngritjen apo uljen e trafikimit me qenie njerëzore, prostitucion**

**Mensut Ademi<sup>1</sup>**

mensut.ademi@aab-edu.net

**Ersin Sylejmani<sup>2</sup>**

Trafikimi i qenieve njerëzore është një nga krimet më të mëdha të kohës sonë dhe një shkelje e të drejtave të njeriut në vetvete. Qeniet njerëzore janë trafikuar për qëllime të punës së detyruar, punësimin e paligjshëm, industrinë argëtuese, martesës të detyruar dhe fallse, prostitucion të detyruar, etj. Në nivelin shoqëror trafikimi manifestohet si një formë moderne e skllavërisë, sepse zakonisht viktima stërvitet në raport me përdoruesit e prostitucionit. Trafikimi i qenieve njerëzore është një nga format profitabile të krimit të organizuar, dhe besohet të jetë me rëndësi për shkak se rreziku është i ulët dhe përfitimi është i madh; pas drogës dhe armëve të tregtisë trafikimi për prostitucion vije si përfitim shumë i madh.

Forma më e zakonshme e trafikimit të qenieve njerëzore është tregtia me qenie njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual, ose për qëllime të prostitucionit të detyruar. Viktimat më të zakonshme të kësaj forme të trafikimit janë gratë dhe fëmijët, te cilët i takojnë grupeve më të rrezikuara sociale.

Veçanërisht interesant është çështja e marrëdhënies midis trafikimit me qenie njerëzore dhe legalizimit të prostitucionit. Nëse vijmë deri te legalizimi i prostitucionit, atëherë çfarë efekti mund të kemi pozitiv apo negativ në raport me zvogëlimin e numrit të personave të trafikuar?

Janë pikërisht ato shtete që e kanë legalizuar prostitucionin te të cilat përmendim faktin si një nga arsyt kryesore që në këtë mënyrë kanë zvogëluar numrin e personave të trafikuar.

Qëllimi i këtij punimi është të tregojë marrëdhëniet midis prostitucionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, dhe të sigurojë analizën dhe konkluzionin se legalizimi i prostitucionit prek trafikimin.

**Fjalë kyç:** *trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni, legalizimi i prostitucionit, shfrytëzimi seksual.*

---

<sup>1</sup> *Phd candidate, Ligjërues në Kolegjin AAB, Juridik-Penal*

<sup>2</sup> *Phd candidate, Ligjërues në SEEU, Tetovë*

## **KORPORATIVNA SIGURNOST U REGIJI ZAPADNOG BALKANA**

**Jasmin AHIĆ<sup>1</sup>**

Rad je analitičkog i elaboracijskog karaktera a sastoji se od nekoliko povezanih cijelina, intro se temelji na empirijskom opisu teme, koju autor obrađuje putem prikaza geneze i nastanka savremenog koncepta vezanog za zakonske regulative korporativne sigurnosti u regiji.

Povijesni nastanak korporativnog sistema sigurnosti u EU, opis korporativne sigurnosti kao strateške poslovne funkcije, u kojoj se prikazuju aspekti korporativne sigurnosti, njen odnos s drugim poslovnim funkcijama, te uloga i važnost korporativne sigurnosti za uspješno poslovanje u savremenim uslovima je cilj ovog rada. Jedinstveno prikazati različite aspekte dizajna procesa korporativne sigurnosti: ustroj organizacijone jedinice za korporativnu sigurnost, obilježja i profil menadžera sigurnosti, kao i ostala radna mjesta organizacijone jedinice integralne sigurnosti. Sve navedeno upućuje na značaj uspostavljanja savremenog koncepta zakonske regulative korporativne sigurnosti i normativni okvir u kojem djeluje korporativna sigurnost. Tranzicijski razvoj poslova korporativne sigurnosti kroz nastanak zakonskih regulativa, kroz koje su prolazile Evopa i BiH i prilagođavale se različitim sistemima i političkim vlastima. Geneza nastanka poslova iz domena poslova korporacijske sigurnosti na teritoriji Bosne i Hercegovine, koju autor prikazuje poređenjem nedostataka bh. zakonodavstva u odnosu na evropsko, ali samo onaj dio koji se odnosi na rad uspostavljanja i funkcionisanja zakona i poslova iz domena rada velikih kompanija.

Zatim tu je opis i značaj infiltriranja ove djelatnosti u sistem sigurnosti svih evropskih država kao neodoljivog djela sistema sigurnosti svake država koji može odgovoriti svim zahtjevima koji su u njenom domenu.

Analitičkim pristupom na kraju autor kritizira rad velikih kompanija i njihovo poštovanje zakona, ukazujući na pozitivne strane, kao i na negativne, upućujući na moguća rješenja koja bi doprinijela i dovela do uspostavljanja cjelovitog i jakog sistema koji se odnosi na korporacijsku sigurnost.

**Ključne riječi:** *korporativna sigurnost, privatna sigurnost, menadžer sigurnosti, agencija, zaštitar, zakon*

---

<sup>1</sup> *Prof.dr Jasmin AHIĆ, Vanredni profesor Fakulteta za kriminalistiku, kriminologiju i sigurnosne studije Univerziteta u Sarajevu*



# ADMINISTRATA DHE POLITIKA

Avni Alidemaj<sup>1</sup>

avni.alidemaj@universitetiaab.com

Administrata Publike është e pozicionuar dhe ndërvepron me nivelin politik i cili i koncipon ligjet dhe merr vendime dhe nga ana tjetër, qytetarëve, që ndikohen drejtpërdrejt nga këto ligje dhe vendime. Rrjedhimisht, administrata ka mundësi të ndihmojë me ekspertizë dhe punë të përditshme politikanët por edhe të ndërmarrë nisma për propozim të ligjeve dhe vendimeve; Të zbatojë ligjet e miratuara nga parlamenti; Të mbikëqyrë jetësimin e akteve ligjore dhe nënligjore; Të vlerësojë efektin e zbatimit të ligjeve dhe nevojën për ndryshimin e tyre. Me fjalë të tjera, administrata publike është elementi qenësor dhe shtylla më e fuqishme e cila siguron stabilitetin brenda një vendi.

Punimi mëton të trajtojë raportin mes nivelit politik dhe aparatit administrativ dhe ndërveprimit mes tyre. Mu për këtë arsye shtjellohen shkollat e ndryshme të mendimit lidhur me raportin mes politikës dhe administratës dhe praktikrat e krijuara në kontekstet e ndryshme. Fokus i veçantë i është dhënë edhe gjendjes aktuale në Kosovë duke shpalosur bazën ligjore dhe praktikrat e krijuara gjatë ndërveprimit mes nivelit politik dhe atij administrativ.

**Fjalë kyç:** *administratë publike, administratë shtetërore, aparat administrative, ndërveprim.*

---

<sup>1</sup> MA, Kolegji AAB, Fakulteti Juridik, Asistent ligjërues

## **Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës**

**Kadri Arifi<sup>1</sup>**

kadri.arifi@gmail.com

Ndryshimet sociale, teknologjike, ekonomike e politike të cilat po ndodhin në rajon e më gjerë kanë ndikuar edhe në rritjen e kompleksitetit të formave të kërcënimeve të sigurisë publike e sidomos të formave të krimit të organizuar dhe terrorizmit. Përballja me këto sfida ndikon në nevojën e fuqizimit dhe ngritjen e efikasitetit të organizatave policore si një nga institucionet kryesore të shtetit. Kjo nënkupton investime në pajisje, teknologji, infrastrukturë ligjore dhe padyshim investime afatgjata të planifikuara mirë të burimeve njerëzore.

Qëllimi i punimit është që të analizohen parimet, procedurat, infrastruktura ligjore si dhe të arriturat dhe sfidat në menaxhimin e burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës.

Në të njëjtën kohë, përderisa Policia e Kosovës është e orientuar kah përmbushja e misionit të vet në hetimin dhe parandalimin e veprave penale, ngritjen e efikasitetit në punë, respektimin e normave kushtetuese e ligjore, respektimin e të drejtave të njeriut dhe kodin e etikës, duhet të merren parasysh edhe kërkesat legjitime të personelit që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre të punës, të sigurimit të jetës, sigurimit shëndetësor e pensional, mbrojtja nga vendimet arbitrare, barazia gjinore e etnike, zhvillim të karrierës dhe kompensimin.

**Fjalë kyç:** *Policia e Kosovës, burimet njerëzore, zbatimi i ligjit, menaxhimi.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, UET, Tiranë

## **Përdorimi i termit ndjekje penale dhe hetim të krimit apo “ndërmarrjes së përbashkët kriminale”**

**Mentor AVDYLI<sup>1</sup>**

mentoravdyli21@hotmail.com

Punimi ” Përdorimi i termit dhe teorisë për ndjekje penale dhe hetim të krimit apo “ndërmarrjes së përbashkët kriminale” është një punim modest që ka për qëllim avancimin e metodës së të shkruarit të punimeve shkencore krahas studimeve tona të nivelit Master, drejtimi Penal pranë Universitetit AAB. Përdorimi i termit dhe teorisë për ndjekje penale dhe hetim të krimit si JCE (Joint Criminal Enterprise - Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale) për herë të parë u shfaq në ICTY përmes një propozimi me shkrim drejtuar kryeprokurores Karla Del Ponte dhe si autor i saj ishte prokurori Dermot Groome shtetas amerikan, që në atë kohë ishte zyrtar ligjor për Bosnje, dhe një nga krye hetuesit amerikan, John Cencich, për krime të kryera në Kroaci. Në vitin 2002, Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJPN-ICC) është themeluar në Hagë (Holandë) dhe Statuti i Romës i siguron GJPN të ketë juridiksion mbi veprat si gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krime lufte. Definicioni i asaj se çka konsiderohet se është një "krim kundër njerëzimit" në procedurat e GJPN është zgjeruar si definicion në mënyrë të konsiderueshme nga ai që ishte origjinal i përdorur nga Kombet e Bashkuara. Në thelb, Statuti i Romës përdor po të njëjtin përkufizim për krime kundër njerëzimit e që edhe Statuti ICTR GJPN për Ruandë po ashtu, duke hequr atë se sulmi është kryer "në baza kombëtare, politike, etnike, racore apo fetare".Përveç kësaj, përkufizimi i Statutit të Romës ofron listën më të gjerë të veprave penale të veçanta që mund të përbëjnë krimet kundër njerëzimit deri tani.

**Fjalë kyç:** *E drejta ndërkombëtare, krime, hetim, Gjykata Penale Ndërkombëtare, Joint Criminal Enterprise.*

---

<sup>1</sup> Student Masc.C, Kolegji AAB, Juridik-Penal

## **Drogat dhe efektet e drogave**

**Doc. dr. Qebir AVZIU<sup>1</sup>**

qebiravziu@gmail.com

Droga nuk është zbulim i njeriut modern, për drogën, është e sigurt se kanë ditur edhe njerëzit parahistorik. Keqpërdorimet e para masive të drogës, sipas dorëshkrimeve të Homerit, kanë filluar në vitin 2500 p.e.s, kur Helena, vajza e Zeusit, ka përgatitur një pije të mrekullueshme me fekete të shumëta që e kanë pirë ushtarët, të cilët pastaj më nuk dinin se çfar është frika dhe trishtimi nga lufta. Në këtë punim kryesisht do të bëhet fjalë për llojet e drogave (kokainë, heroinë, kanabis sativa etj) që më së shumti përdoren në R.Maqedonisë, si dhe efektet që shkaktohen nga përdorimi i tyre. Poashtu shkurtimisht do të përmednim edhe tregtin me drogës që paraqet industrin e madhe botërore me fitim vjetor prej 750 miliard dollarë.

**Fjalë kyç:** *Droga, llojet e drogave, efektete e drogës, tregtia me drogë etj.*

---

<sup>1</sup> *Autori është profesor i Kriminalistikës në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Një periudhë të gjatë (20 vjet), ka punuar në MPB të RM-së, ku ka qenë udhëheqës i sektorit të kontrollit të brendshëm, sektorit për të huaj, inspektor kryesor në departamentit e krimit të organizuar etj.*

# **Veprat penale krim kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare në Kosovë 1998-99**

**Arsim Beka<sup>1</sup>**

arsim1.beka@gmail.com

Punimi “Veprat penale krim kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare Kosove 1998-99” është një punim modest që ka për qëllim avancimin e metodës së të shkruarit të punimeve shkencore krahas studimeve tona të nivelit Master, drejtimi Penal pranë Universitetit AAB. Përmes këtij angazhimi ne jemi munduar që të nxjerrim disa karakteristika të kohës së kaluar dhe asaj të sotme apo shoqërisë bashkëkohore, lëvizjet e njerëzve, emigracionet e njerëzve nga një vend në vendin tjetër, krizat politike, luftërat, sistemet jodemokratike apo diktatoriale, luftërat, krimet dhe veprat penale kundër njerëzimit dhe angazhimet ndërkombëtare, legjislacionet apo konventat ndërkombëtare në drejtim të mbrojtjes së të drejtave humane të njerëzimit dhe ndëshkimit të kryerësve të veprave të ndryshme penale dhe krimeve kundër njerëzimit. E drejta e jetës është një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e cila është e sanksionuar dhe e garantuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Askush nuk ka të drejtë t’ia marrë jetën dikujt tjetër. Mbrojtja e njerëzimit ka qenë dhe mbetet një ndër detyrat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe shteti. Ajo sigurohet me mënyra e mjete të ndryshme parandaluese e ligjore. Vend të veçantë zë mbrojtja juridike penale e njerëzimit, e cila parashikon veprat penale që drejtohen kundër tij si dhe dënimet penale kundër tyre. Këtij qëllimi i shërben edhe Konventa për parandalimin dhe ndjekjen e krimit të gjenocidit, e miratuar dhe e paraqitur për nënshkrim, ratifikim ose aderim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më rezolutën e saj 260A(III) të 9 dhjetorit 1948.

**Fjalë kyç:** *E drejta ndërkombëtare, krime kundër njerëzimit, Gjykata Ndërkombëtare, krime lufte.*

---

<sup>1</sup> Student Masc.C, Kolegji AAB, Juridik-Penal

## **Tregtia e lirë dhe efektiviteti i saj në zinxhir të vlerës të produkteve ushqimore në Kosovë**

**Isak Berbatovci<sup>1</sup>**

Zinxhiri i vlerës ka të bëjë me fluksin e produktit nga materiali i pa përpunuar deri te përdoruesi i fundit. Qëllimi i hapjes ose liberalizmi i tregjeve përfshijnë rritjen dhe zhvillimin ekonomik, rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit, përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga shteti, rritjen e konkurrencës dhe çmime më të ulëta për konsumatorin. Bashkëpunimi në tregti mund të sjellë suksesin por mund te jete sfidë për sektorin e produkteve ushqimore të Kosovës si vend i vogël që përballet nga rajoni "i madh". Për këtë një analizë e tregtisë së lirë dhe zinxhirit të vlerës do të shërbente si bazë për të kuptuar më mirë se si ndikon tregtia e lirë në aktorët e zinxhirit e vlerës të produkteve ushqimore. Qëllimi i këtij punimi është të identifikohen aktorët e zinxhirit të vlerës, efektiviteti i tregtisë së lirë në aktorët të zinxhirit e vlerë të produkteve ushqimore, mundësitë dhe sfidat që përballen këta aktorë si rezultat i tregtisë së lirë.

Një nga gjetjet e këtij punimi është se tregtia e lirë i ka ulur çmimet e produkteve ushqimore në treg, por e ka vështirësuar konkurrencën e produkteve lokale.

E ardhmja e zinxhirit të vlerës është në rritjen e effciences së aktorëve të zinxhirit vlerës, kualitetin, subvencionet e marra nga shteti dhe zvogëlimin e koston së prodhimit.

**Fjalë kyç:** *tregtia e lirë, zinxhiri i vlerës, aktorët e zinxhirit, produktet ushqimore.*

---

<sup>1</sup> *Phd Candidate* , Universiteti European i Tiranës

## **Evolimi i të drejtës penale në lidhje me mbrojtjen e shoqërisë nga vepra “Kontrabandimi i narkotikeve” në territorin e Kosovës**

**Avdi BERISHA<sup>1</sup>**

avdi.berisha1@hotmail.com

Evolimi i të drejtës penale në lidhje me mbrojtjen e shoqërisë nga vepra “Kontrabandimi i narkotikeve” në territorin e Kosovës

Duke parë dinamikën e përhapjes së dukurisë kriminale të “kontrabandimit të lëndëve narkotike”, vihet re se përveç ndikimeve në aspektin mjekësor e social pati edhe në atë juridik. Problematikat e kësaj vepre penale kanë tërhequr vëmendjen e juristëve dhe të hartuesve të politikave, për ta luftuar dhe parandaluar në të gjitha format e mundshme dhe në mënyrë të organizuar. Individët që abuzojnë me lëndët narkotike, përveçse dëmtojnë rëndë shëndetin e tyre, shfaqin edhe sjellje jo-sociale. Në këtë mënyrë, ata bëhen kontingjent shoqëror më i prirë për të kryer krime të ndryshme.

Në këtë trajtim analizohen problematikat e shumta të lidhura me përhapjen e veprave penale në fushën e lëndëve narkotike, midis të cilave një vend të rëndësishëm zë edhe prodhimi, trafikimi, tregtimi dhe përdorimi i substancave narkotike dhe psikotrope. Trajtimi do të fokusohet jo vetëm në kuadër të legjislacionit tonë, por edhe në një vështrim në zhvillimin e së Drejtës Ndërkombëtare, si edhe në rolin rregullator të shtetit dhe organeve të sistemit gjyqësor në kuadër të rregullimeve ligjore dhe zbatimit të tyre.

**Fjalë kyç:** *kontrabandim, narkotik, akte juridik, drejtësi ndërkombëtare.*

---

<sup>1</sup> Student Masc.C, Kolegji AAB, Juridik-Penal

## **Etiologjia dhe rëndësia e saj në shpjegimin dhe ndriçimin e rrugëve të cilat shpjen deri te kriminaliteti**

**Fidair BERISHA<sup>1</sup>**

fidair.berisha@hotmail.com

Krimi si dukuri ka qenë dhe mbetet bashkudhëtar dhe preokupim i të gjitha kohërave dhe etapave njerëzore. Etiologjia kriminale konsiderohet si njëri ndër sektorët më të rëndësishëm në studimet dhe kërkimet që kanë të bëjnë me kriminalitetin në përgjithësi. Pra, etiologjia analizon dhe studion lidhjet kauzale në mes te rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm të kriminalitetit. Po ashtu etiologjia kriminale studion dhe bënë hulumtimin e shkaqeve dhe rrethanave që kanë të bëjnë më të gjitha sjelljet kriminale dhe dukuritë e tjera negative në shoqëri. Në kryerjen e krimeve ndikojnë disa shkaqe, të cilat mund të jenë të brendshme ose te jashtme dhe pikërisht për këtë studimet etiologjike merren me faktorët objektivë-ekzogjenë dhe faktorët subjektivë-endogjenë, të cilët e kushtëzojnë fenomenin e kriminalitet dhe dukurive të tjera antisociale dhe negative në shoqëri. Faktorët që ndikojnë në kriminalitet janë të shumëllojshëm dhe të natyrave të ndryshme ,dhe nuk veprojnë të shkëputur nga njeri tjetri,por janë te ndërlidhur me njeri tjetrin. Andaj për të ardhur deri te një përfundim sa me i saktë lidhur me shkaqet e krimit në përgjithësi, etiologjia kriminale merret me në detaje me këtë lëmi në mënyrë që të gjinden faktorët kryesorë të kriminalitetit.

**Fjalë kyç:** *Krimi,etiologjia kriminale,shoqëria,lidhjet kauzale.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Universiteti i Sarajevës, Fakulteti per Kriminalistike, Kriminologji, Studime te Sigurisë



# Roli dhe rëndësia e gjurmëve kriminalistike në zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit

Fadil Berisha<sup>1</sup>

fadili29@hotmail.com

Shumë kriminalistë të njohur kanë formuluar përkufizimet e veta lidhur me nocionin e gjurmës. Në përgjithësi të gjithë pajtohen se gjurmë është e gjithë ajo që e lë njeriu, kafsha ose lënda, që mund të shërbejë për zbulimin e kryesit ose të konstatohen disa rrethana individuale, me gjurmët mund t'i kuptojmë, "gjurmë janë ndryshimet e dukshme apo të padukshme të cilat me veprimin fizik i ka shkaktuar njeriu, kafsha ose ndonjë lëndë tjetër me rastin e kryerjes ose lidhur me kryerjen e veprës penale." (Në librin "Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimin" e botuar në vitin 2009 në Prishtinë, Prof. Dr. Vesel Latifi). Me gjurmë në aspektin kriminalistik sot nënkuptohen ndryshimet materiale në realitetin objektiv, të cilat janë të njohura dhe të cilat janë krijuar në lidhje ose me rastin e kryerjes së veprës penale ose përgatitjes së veprës penale dhe të cilat kanë një vlerë të caktuar dëshmuese në procedurën e identifikimit kriminalistik. Fjala është për ndryshimin material në realitetin objektiv në raport me gjendjen ekzistuese para ndryshimit, gjegjësisht para kryerjes ose tentimit të veprës penale. Në zbulimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale, gjurmët, qoftë në kuptimin e gjerë apo të ngushtë, kanë vlerë provuese të njëjtë. Gjurmët e gjakut, për shembull, të zbuluara në vendin e ngjarjes, nuk kanë me pak vlerë provuese se gjurmët e gishtave, kur ato lidhen me ngjarjen që ka ndodhur.

**Fjalë kyç:** *Traseologjisë kriminalistike, gjurmë, zbulimi, luftim.*

---

<sup>1</sup> MSc, Kolegji AAB, Fakulteti Juridik

## **Crna Gora i vladavina prava**

**Djordjije Blažić<sup>1</sup>**

dekanat@fdes.me

Crna Gora i vladavina prava u kontekstu Evroatlanskih integracija.

Prezentacija bi se bavila najpre ustavno pravnim obeležjima Crne Gore, njenim držanim uređenjem, oblikom vladavine ,političkim režimom i oblikom organizacije državne vlasti . Kratko izlaganje bi se bavilo bitnim aspektima ovih pitanja kao i reformama Crne Gore u procesu pridruživanja evro-atlanskim integracijama . U to kontekstu posebno bi se obratila paznja na ustavne promjene u oblasti jačanja pravosudja i borbi protiv kriminala i korupcije te reformama sudskog sistema, državnog tužilaštva , bezbjednosnih agencija , ali i na reforme u oblastima ljudskih prava i sloboda, upravnim reformama , lokalnoj samoupravi . Posebno atuelno u ovom trenutku je reforma upravno sudskih postupaka i strategija reforme javne uprave za period 2016-2020 godina kojima se zeli pojačati vladavina prava i slobode gradjana uključujući i aktivnosti na NATO integracijama.

---

1

# Studije samoprijavljivanja u detekciji prestupništva mladih - upotrebna vrijednost u socijalnoj kriminalnoj prevenciji

Muhamed Budimlić<sup>1</sup>

Savremena socijalna kontrola kriminaliteta, posebno njeni segmenti zaduženi za pravosuđe, slobodu i sigurnost, temelje se na programima za sprječavanje i suzbijanje ovih oblika ponašanja, koji su bazirani na poznavanju i registrovanju kriminaliteta. Rezultati naučnoistraživačkih poduhvata iz oblasti kriminologije nezamjenjiv su izvor spoznaja za unaprijeđenje institucionalne socijalne reakcije na kriminalno ponašanje. Ovakav model politike suprotstavljanja kriminalitetu doprinosi uspješnom rješavanju pitanja sigurnosti, kao jednom od najosnovnijih pitanja zabrinutosti građana.

Neprihvatljiva ponašanja mladih predstavljaju manifestacije po kojima se može cijeliti stepen razvoja društva. Kvalitetna detekcija etiološke dimenzije ovog društvenog problema obuhvata isagledavanje sadržaja i strukture mjera socijalne kontrole kao i socijalne reakcije na ovu pojavu. Efikasnost i efektivnost mjera koje društvo preduzima, kako u represivnim tako i u preventivnim nastojanjima, direktno se ispoljavaju kako na kvantitativnu tako i na kvalitativnu dimenziju prestupničkog ponašanja mladih.

Obzirom da je za poduzimanje preventivnih mjera neophodno poznavanje uslova i uzorka prestupničkog ponašanja, imperativnim se postavlja potreba provođenja kriminoloških istraživanja usmjerenih u tom pravcu. Kao jedan od najreferentnijih i najpouzdanijih metodoloških postupaka u oblasti istraživanja etiologije i fenomenologije prestupničkog ponašanja mladih danas se koriste studije samoprijavljivanja. Rezultati istraživanja provedenih ovom metodom doprinose sagledavanju elemenata socijalne kontrole u kontekstu "samoprijavljenih" oblika prestupničkog ponašanja. Poseban značaj rezultata ovih studija odnosi se na mogućnost planiranja i programiranja mjera socijalne kriminalne prevencije prema populaciji mladih, što je i oblast u kojoj ovaj rad treba da ostvari kako naučni tako i društveni doprinos.

**Ključne riječi:** *sigurnost u zajednici, strategija suprotstavljanja kriminalitetu, socijalna kriminalna prevencija, prestupništvo mladih, kriminalna etiologija i fenomenologija, tamna brojka kriminaliteta, studije samoprijavljivanja.*

---

<sup>1</sup> Prof.dr.sc. Muhamed Budimlić, Fakultet za kriminalistiku, kriminologiju i sigurnosne studije, Univerzitet u Sarajevu

## **Risitë e rregullimit ligjor dhe organizimit të Shërbimit Korrektues në Kosovë**

**Vilard BYTYQI<sup>1</sup>**

vilardbytyqi@gmail.com

Institucioni bosht që merret me ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë është Shërbimi Korrektues i Kosovës. Që nga themelimi, ky institucion ka pësuar ndryshime të shumta si nga ana organizative, ashtu edhe nga ana e rregullimit ligjor. Ndryshimet e shumta të cilat kanë ndodhur në Kodin Penal të Kosovës, kanë reflektuar natyrshëm edhe në punën dhe veprimtarinë e saj. Për rolin dhe rëndësinë e këtij institucioni tanimë dihet, ato kanë shënuar rezultate të shumta dhe pozitive.

Trendët e fundit të cilat kanë ndodhur në shërbimet korrektuese në shoqëritë demokratike, kanë bërë që këto shërbime të marrin karakter human dhe në raste të shumta edhe faktor vendimtar që delinkuentët të cilat procedura penale me vendim të formës së prerë i ka dënuar për krime të rënda, të njëjtit t'i rehabilitojë përmes programeve që në përmbajtje ka pasur riedukim, risocializim, ri-integrim. Sot, bota demokratike është e koncentruar që praktikave të dënimeve me burgim t'i shmangen në rastet më të mëdha dhe përparësi t'u jepet dënimeve alternative me karakter sprovues.

Programet që në përmbajtje kanë masën e paraburgimit për sigurimin e të pandehurit në procedurë, por edhe dënimin me burgim si lloj i dënimit më të rëndë, po konsiderohen si programe të praktikës së vjetër dhe është përcaktuar si objektiv që në një të ardhme të afërt, programet me natyrë korrektuese, për aq sa është e mundur të zëvendësohen me programe sprovuese, pasi që qëllimet e rehabilitimit, riedukimit, risocializimit apo ri-integrimit po tregohen programe më të përshtatshme për t'i arritur këto qëllime.

**Fjalë kyç:** *shërbimi korrektues, sanksionet penale, shoqëria demokratike etj.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, South East European University

# Besueshmëria e institucioneve publike në tranzicionin e Evropës Juglindore

Jonida Jorgu<sup>1</sup>

jdrgu@yahoo.com

Problemi i pandershmërisë dhe mosbesimit është shpesh herë i paqartë në Evropën Lindore. Këto çështje janë të zakonshme në mediet e shkruara dhe televizione, por gjithashtu i gjejmë të diskutuara në familje në vendet e punës por edhe ambientet shoqërore. Korrupsioni, përfitimi në mënyrë të padrejtë, gënjeshtria, hileja dhe abuzimi me besimin janë të përmendura së shpeshti gjatë këtij dhjetë vejtshi të fundit ose dy dhjetëvjeçarëve të fundit pas ndërrimit të sistemit. Megjithëse, pandershmëria dhe mosbesimi (+korrupsioni) kanë ekzistuar edhe në sistemin e mëparshëm, gjithsesi ato kanë qenë fenomene të fshehura ose çështje për të cilat nuk flitej në këtë sistem.

Kërkimet për sa i përket ndershmërisë dhe besimit përfshijnë shumë fusha në sektorë të ndryshëm. Letërsia ndërkombëtare në këtë subjekt përqendrohet në dy tema thelbësore. Njëra prej të cilave është besimi dhe marrëdhënia e tij me kapitalin social.

Çka nënkuptojmë me këto koncepte? Çfarë ndikon në perceptimin e tyre?

Cilat janë përfitimet dhe efektet e dëmshme të besimit dhe si janë të lidhura me kapitalin social dhe konsolidimin demokratik?

Kërkimi i kësaj teme është interdisiplinar sepse ai përfshin si shkencat politike, shkencat sociale, politike, ato juridike apo sociologjike e antropologjike.

Si përfundim : Korrupsioni është një sjellje e pandershme që përfshin dhe dhunon besimin e vendosur mbi zyrtarë dhe zyrtarët publikë. Ai përfshin përdorimin e pozicioneve publike për përfitim personal.

**Fjalë kyç:** *korrupsioni, tranzicioni, letërsia ndërkombëtare etj.*

---

<sup>1</sup> Phd Candidate Univeristeti i Tiranës, Shkenca Politike

## **Ankesat dhe parashtresat lidhur me procesin zgjedhornevoja për ndryshim**

**Florian Dushi<sup>1</sup>**

fdushi@gmail.com

Republika e Kosovës ka shpallur pavarësinë e saj në vitin 2008. Pas aktit të shpalljes së pavarësisë, disa muaj më vonë, kishte hyrë në fuqi kushtetuta e re e Republikës së Kosovës dhe një mori ligjesh të reja të cilat rregullonin segmente të caktuara të jetës shoqërore në Kosovë. Ndër të tjera, edhe ligji për organizimin e zgjedhjeve në Kosovë, i cili përveç tjerash, përcaktonte edhe organin përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve dhe të referendumeve por edhe organin për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave që kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e organizimit të zgjedhjeve në Kosovë. Organi i paraparë për këtë çështje, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, për nga mënyra e themelimit, përbërjes dhe funksionimit, përbënë rast paksa të veçantë nga praktikat që mund të gjinden në shtete të ndryshme por që kanë specifika të përafërta me Kosovën.

Prandaj, meqë këto çështje kanë rëndësi tepër të madhe për secilën demokraci dhe përbëjnë dëshmi të fuqishme të vetë funksionimit të shtetit juridik, sidomos për Kosovën e cila konsiderohet si demokraci tejet e re, dhe meqë zgjedhjet përgjithësisht akoma janë proces tejet sfidues për gjithë shoqërinë dhe për organet përgjegjëse për organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre sidomos, roli dhe funksionimi i këtij organi, jo rrallë ishin objekt i debateve të shumta të përcjella shpesh edhe me kërkesat për të ndryshuar dhe për të bartur këtë përgjegjësi, shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave dhe parashtresave që ndërlidhen me zgjedhjet, drejtpërdrejt tek organet gjyqësore.

**Fjalë kyç:** *procesi zgjedhor, referendum, demokraci, shteti juridik*

---

<sup>1</sup> MSc, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik

## Partitë politike dhe sundimi i ligjit në Kosovë

Artan Fejzullahu<sup>1</sup>

artan.fejzullahu@universitetiaab.com

Luz Balaj<sup>2</sup>

Partitë politike në Kosovë, në agjendat ditore, në kuadër të aktiviteteve qoftë elektorale apo edhe jashtë fushatave zyrtare elektorale, kanë një dedikim programor tejet të përkushtuar ndaj rendit dhe ligjit. Por, cili është roli i partive politike në ngritjen e kapacitetit të sundimit të ligjit, mund të kuptohet nëse analizojmë me kujdes, mekanizmat që në radhë të parë mundësojnë funksionimin demokratik të partive politike. Partive politike në Kosovë, u mungon një mekanizëm i mirëfilltë i kontrollit. Kontroll ky që do të mundë të ishte efektiv që nga momenti i shfaqjes së interesit të një grupi të caktuar për ta regjistruar veprimtarinë e tyre si subjekt- parti politike. Kontrolli ndaj veprimtarisë së partive politike, mekanizmat ekzistues për të kontrolluar këtë veprimtari, organizimin dhe po ashtu zgjedhjet apo procesin e brendshëm elektorale, janë disa nga shqetësimet, të cilat vazhdojnë t'i përcjellin partitë politike në Kosovë. Këto edhe si pasojë e një mos orientimi adekuat dhe programor që mund të kuptohet si një shqetësim shtesë për jetën politike në vend. Konkretisht, organizimi i partive politike në një prezencë të theksuar të elementit nacional, financimi i partive politike dhe mungesa e një prerogative kushtetuese që Gjykata Kushtetuese të mundë të interpretojë kushtetutshmërinë e statuteve dhe veprimtarisë së partive politike, janë tema bosht që do të trajtohen në punim. Duke përdorur raporte nga organizata që kanë asistuar në demokratizimin e partive politike në Kosovë si NDI, USAID etj, punimi do të ofrojë një gjendje reale të organizimit të partive politike në Kosovë, dedikimit të tyre drejt demokratizimit dhe po ashtu do të ofrojë disa sugjerime konkrete, se si mund të rritet roli i partive politike për më shumë rend dhe ligj.

**Fjalë kyç:** *dedikimi programor, mekanizmi i kontrollit, elementi nacional, kushtetutshmëria e statuteve.*

---

<sup>1</sup> PhD CAND, Universiteti i Prishtinës, Ligjërues, Kolegji AAB , Juridik-Administrativo Kushtetues

<sup>2</sup> PhD CAND, Universiteti i Prishtinës

## **Funksionimi i sistemit të sigurisë në Kosovë dhe reziq nga krimi i organizuar dhe terrorizmi**

**Hajdar Hoti<sup>1</sup>**

hajdar.hoti@universitetiaab.com

Duke u nisur nga fakti se Kosova është një shtet ri me institucione relativisht të reja, kemi parë të rrugës që nëpërmjet këtij punimi të japim kontributin tonë në studimin dhe hulumtimin e rreziqeve të sigurisë nga krimi i organizuar dhe terrorizmi me theks të veçantë të drejtura kundër sistemit të sigurisë në Kosovë. Këtë jemi munduar ta bëjmë duke i studiuar rreziqet potenciale në drejtim të Kosovës.

Në këtë punim do të hasni në një çështje të trajtuar që në Kosovë është mjaft aktuale, këtë e themi duke marrë parasysh faktin që sot numri i madh i krimeve është gjithnjë e më shumë në rritje si në vendet e zhvilluara aq më shumë në vendet në tranzicion ku bënë pjesë edhe Kosova. Prandaj në punim jemi munduar të japim shpjegime sa më të qarta rreth krimit të organizuar, format e paraqitjes së tij dhe rreziqet që mund të vijnë nga ai, duke marrë si shembull Kosovën dhe rreziqet që mund t'i vijnë nga korrupsioni, trafikimi me qenie njerëzore, kontrabandës me narkotikë etj., Por duke e trajtuar edhe fenomenin e terrorizmit, format e tij dhe rreziqet për sigurinë. Gjithashtu do t'i trajtojmë edhe strategjitë kundër këtyre fenomeneve, si dhe historikun e funksionalizimit të sistemit të sigurisë në Kosovë, pa i lanë anash institucionet e krijuara pas luftës.

**Fjalë kyç:** *krim i organizuar, terrorizmi, korrupsioni, trafikimi me qenie njerëzore.*

---

<sup>1</sup> MA, Universiteti I Sarajvës, Fakulteti për Kriminalistikë, Kriminologji dhe Sisteme të Sigurisë



## Lëndë e konfliktit administrativ

**Xhemazie Ibraimi<sup>1</sup>**

dzemazie.i@hotmail.com

Veprimtaria e organeve administrative përfshinë tërësinë e akteve dhe të veprimeve të ndryshme, nëpërmjet të cilave formohet dhe shfaqet vullneti i administratës publike. Ky vullnet i organeve të administratës publike, i shprehur në aktet administrative individuale e normative, në kontratat administrative dhe në aktet reale, gjen pasqyrimin e tij në Kushtetutë, në ligje si dhe në dispozitat e tjera me karakter nënligjor. E gjithë kjo veprimtari nuk është e pagabueshme dhe për rrjedhojë, as e pakontrollueshme. Mbikëqyrja e veprimtarisë ekzekutive i nënshtrohet si kontrollit politik të akteve administrative nëpërmjet organeve të caktuara për këtë qëllim, ashtu edhe kontrollit të brendshëm dhe atij gjyqësor.

Institucioni i kontrollit gjyqësorë i veprimeve dhe akteve administrative paraqitet tepër i rëndësishëm dhe trajtohet gjerësisht në doktrinën juridike. Mbrojtja e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave privatë realizohet duke ia nënshtuar veprimtarinë administrative si kontrollit të brendshëm administrativ, ashtu edhe atij gjyqësor në përputhje me dispozitat ligjore.

Kontrolli gjyqësor i akteve administrative përbën një garantim kushtetues për qytetarët për mbrojtjen e të drejtave të tyre, nëpërmjet gjykimit të drejtë publik dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në këtë mënyrë Kushtetuta autorizon gjykatën e zakonshme administrative që bën të pavlefshëm një veprim ose akt administrativ, mirëpo jo të gjitha aktet administrative mund të jenë lëndë e konfliktit administrativ, në përjashtim me çështjet kundër të cilave nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ (ENUMERACIONI NEGATIV).

**Fjalë kyç:** *organe administrative, veprime administrative, akte administrative, mbikëqyrje administrative, kontroll gjyqësor.*

---

<sup>1</sup> Dr.sc. Universiteti i Prishtinës, ligjëruese në Kolegjin AAB.

## **Bashkëpunimi në mes të shërbimeve inteligjente dhe policisë në parandalimin e terrorizmit**

**Ganimete Ismajli<sup>1</sup>**

ganimete.ismaili@aab-edu.net

**Fatmir Qollakaj<sup>2</sup>**

fatmir.qollakaj@aab-edu.net

Terrorizmi dhe krimi i organizuar, e posaçërisht terrorizmi gjithnjë e më shumë po imponohet si kërcënimi më serioz dhe sfida e të gjitha sfidave për sigurinë nacionale dhe sigurinë ndërkombëtare. Së këndejmi edhe mobilizimi nacional dhe ndërkombëtar për t'u përballur me këtë sfidë. Doktrina dhe koncepti i deritanishëm i mbrojtjes nga këto kërcënime dhe këto sfida si duket rezulton të jetë i pamjaftueshëm apo i “ ngushtë”, pra duhet ridefinuar e ristrukturuar edhe strategjia e luftimit dhe parandalimit të këtij lloji të kërcënimit të sigurisë. Në këtë ristrukturim e ridefinim të strategjisë pa mëdyshje se vendi primar i takon nevojës së një bashkëpunimi strategjik në mes të shërbimeve inteligjente dhe policisë. Kur e themi këtë e kemi parasysh situatën e re të krijuar dhe imponimin agresiv të terrorizmit bashkëkohor, përveç vrazhdësisë, karakteristikë tjetër e manifestimit të aktiviteve terroriste sot është edhe taktika e zhdërvjelltësia e grupeve terroriste si dhe indoktrinimi i intensitetit të lartë, karakteristikë kjo e fundit që i bën vështirë të mposhtën. Ky indoktrinim i thellë ideologjik mbi baza fetare apo nacionale rrit nevojën e parandalimit dhe demistifikimit e deideologjizimit të tyre. Kjo strategji e re nuk mund të jetë e suksesshme pa një bashkëpunim shumë të ngushtë në mes shërbimeve inteligjente dhe policisë. Kur themi shërbimet inteligjente, mendojmë në shërbimin inteligjent të shtetit përkatës dhe shërbimet inteligjente të shteteve mike, të shteteve të koalicionit kundër terrorizmit global.

**Fjalë kyç:** *terrorizmi, shërbimet inteligjente, siguria, shteti, ideologjia.*

---

<sup>1</sup> Ma.sc. Ganimete Ismajli , Asistente , Fakulteti Juridik , AAB

<sup>2</sup> Mr.sc. Fatmir Qollakaj , Ligjërues , Fakulteti Juridik , AAB

## **Nocioni i regjimit pasuror në marrëdhëniet bashkëshortore sipas legjislacionit shqiptar**

**Xhensila KADI<sup>1</sup>**

xhensila.kadi@fdut.edu.al

Me lidhjen e martesës, mes bashkëshortëve krijohen jo vetëm marrëdhënie me karakter personal por edhe marrëdhënie me karakter pasuror. Marrëdhëniet pasurore klasifikohen në marrëdhënie me karakter periodik, që lidhen me shpenzimet e jetës së përditshme duke përfshirë këtu kontributin material që secili bashkëshort jep për mbarëvajtjen e familjes, dhe marrëdhënie që e tejkalojnë këtë kuadër. Këto të fundit lidhen me pasurinë që secili prej bashkëshortëve mund të fitojë gjatë martesës.

Mund të ndodhë që bashkëshorti, pasi ka përmbushur detyrimin për kontribut material në interes të familjes, të ketë të ardhura të tjera. Këto të ardhura ai mund të vendosë t'i investojë, t'i përdorë për të blerë sende të luajtshme apo të paluajtshme, t'i depozitojë në bankë, etj. Në një situatë të tillë lind pyetja se cilit prej bashkëshortëve do t'i përkasin këto sende apo të drejta të fituara gjatë martesës. Si do të ndahen ato në rast se përfundon martesja?

Nëpërmjet këtij punimi, synojmë t'i japim përgjigje pyetjeve të mësipërme duke u bazuar në Kodin e Familjes.

Titulli i tretë i pjesës së dytë të kodit rregullon regjimin pasuror martesor mes bashkëshortëve. Nocioni i regjimit pasuror martesor përcaktohet në nenin 66 të kodit i cili përcakton se regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij kodit dhe legjislacionit përkatës.

**Fjalë kyç:** *martesë, regjim pasuror martesor, bashkëshortë, kodit i familjes.*

---

<sup>1</sup> Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë

## **Politikëbërja në një shtet multietnik - rasti i Maqedonisë**

**Besa KADRIU<sup>1</sup>**

besa.kadriu@seeu.edu.mk

Përvoja e deritanishme e studimeve tregon se në të shumtën e rasteve shoqëritë me përbërje multietnike të cilat niveli i zhvillimit demokratik është më i kufizuar, mungesa e kapaciteteve institucionale të mirëfillta që do të funksiononin në mënyrën e duhur, mos përfshirja në administrimin publik në përbërje etnike të barabartë si dhe një sërë faktorësh të tjerë janë shoqëri më shumë të predispozuar për të pasur konflikte. Mu për këtë është shteti dhe autoritetet shtetërore ato të cilat kanë përgjegjësinë dhe legjitimitetin për të vepruar në mbrojtje të interesit publik dhe vlerave të asaj shoqërie multietnike.

Hulumtimi në fjalë do të mundohet të nxjerrë në sipërfaqe praktikën e Maqedonisë nga periudha e vitit 2001, periudha pas konfliktit të armatosur dhe “ Marrëveshjes kornizë të Ohrit”.

Përmeshja e standardeve të parapara në realizimin e marrëveshjes kornizë dhe procesit të politikëbërjes në përgjithësi duke i krahasuar këto praktika me një sërë sfidash të cilat janë edhe përgjegjësi dhe detyrim për vendet që kanë aspirata për t’ju bashkangjitur strukturave të BE-së.

**Fjalë kyç:** *multietniciteti, institucionet, konfliktet, demokratizimi, standarde, politikëbërje, etj.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, South East European University, Public Administration & Political Sciences Faculty

## **Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm – organizimi i shtetit ligjor në luftën kundër këtyre dukurive**

**Ejup KAMBERAJ<sup>1</sup>**

ejupkamberaj@gmail.com

Bazuar në përmasat aktuale të paraqitjes së këtyre dukurive shoqërore në forma të dhunshme, të apostrofuara si dukuri e shëmtuar e manifestuar në formë të kriminit të organizuar, i përcjellë me akte vandale ndaj njerëzimit dhe të mirave të tyre, jemi fokusuar që përmes kësaj konference sado pak ta perceptojmë edhe juridikisht përkufizimin dhe format e paraqitjes së tyre.

Për të sqaruar dhe për të qenë ma konkret, punimi im do të përqendrohet në këto përkufizime:

- Çka është radikalizmi-cili është përkufizimi juridik i tij?
- Çka është ekstremizmi- cili është përkufizimi juridik i tij?
- Si është bërë përkufizimi politiko-juridik i këtyre dukurive në mekanizmat institucionalë në Republikën e Kosovës?
- Cila është fenomenologjia kriminale e tyre?
- Kur sjelljet ekstreme dhe radikale, mund të cilësohen si vepra penale (të ndaluara)?
- Cilat janë politikat preventive në parandalimin e këtyre akteve të dhunshme?

Bazuar në paraqitjet e këtyre dukurive në shoqëri, sidomos gjatë viteve të fundit në disa vende botërore, ka lindur interesimi që të ngritët kjo çështje në përmasa shkencore, por edhe institucionale. Me gjithë seriozitetin dhe rrezikshmërinë që i paraqiten njeriut dhe të sigurisë kombëtare të shteteve dhe rajonit, një përkufizim i qartë dhe i pranuar gjerësisht për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, ende mungon. Gjithashtu, ende nuk kemi përkufizim të plotë dhe të qartë se si duhet të përballemi me këto dukuri.

Janë parë të nevojshme edhe hapja e mundësive shkencore dhe përkufizimet juridike të koncepteve të lartcekura, se në cilën fazë të paraqitjes të këtyre dukurive, duhet reaguar shoqëria.

Punimi shkencor, ka për qëllim cilësimin juridik të këtyre dukurive apo fenomeneve të cilat janë prezentë në kohën aktuale kur ato manifestohen me akte të dhunshme.

**Fjalët kyç:** *Radikalizmi, ekstremizmi, shteti ligjor etj.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Universiteti i Sarajevës

## **Tapitë e perandorisë osmane - bazë e njohjes së pronësisë në Kosovë**

**Muhamet Kelmendi<sup>1</sup>**

muhamet.kelmendi@aab-edu.net

Në vazhden e fitimit të pronësisë mbi sendet e paluajtshme në Kosovën e pas luftës ka një parregullësi të përgjithshme, sepse shumë fakte relevante historike, si tapitë e kohës së Perandorisë Osmane, nuk janë marrë për bazë për të njohur pronësinë në Kosovë. Këndej janë marrë vetëm provat e pushtuesit serbo-jugosllav, të cilat i kanë injoruar raportet pronësore të krijuara mbi fakte pronësore gjatë historisë, para pushtimit të Kosovës, në llogari të kolonizatorëve, të cilët janë sjellur nga Qeveria e Beogradit pas vitit 1918.

Mu këto prova janë pranuar fillimisht nga UNMIK dhe tash nga organet e shtetit të Kosovës. Natyrisht se kjo formë e punës, e cila është tërësisht antiligjore dhe në kundërshtim me shkencën mbi marrëdhëniet pronësoro-juridike, ka eliminuar pronarët e vërtetë të patundshmërisë në llogari të kolonizatorëve, te atyre që me dhunë dhe terror, me masa represive dhe me kolonizim e kanë krijuar pronësinë në patundshmëri të Kosovës.

Çështja e pronësisë është një e drejtë e patjetërsueshme dhe themelore. Jo pa qellim, qëndron në shkencë ideja se prona është e drejta themelore dhe e garantuar me akte normative.

Thuhet: “Prona private është e amshueshme dhe e drejtë themelore e njeriut”.

Vetë ky përkufizim juridik tregon se ajo (prona) është e një rëndësie të veçantë dhe se nuk tjetërsohet me masa të ndryshme. Ajo mbrohet me ligje të vendit dhe me norma ndërkombëtare, si dhe me konventat e ndryshme të karakterit ndërkombëtar mbi marrëdhëniet pronësoro-juridike. Askush nuk përjashtohet nga kjo e drejtë. Është e drejtë themelore, krahas jetës dhe të drejtave qytetare, lirive nacionale, etj. Prona mbetet e mira kryesore.

**Fjalë kyç:** *pronësia, tapitë, kolonizatorët, masat represive, ligji*

---

<sup>1</sup> Prof.asoc. Dekan në Kolegjin AAB, Fakulteti Juridik

## **Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, aktualiteti dhe rrezikshmëria**

**Fatmire Krasniqi<sup>1</sup>**

fatmireshaipkrasniqi@gmail.com

Njohuritë thelbësore mbi trafikun publik dhe rregullat që vlejné rreth tij, na bëjnë të ditur se, në aspektin e përgjithshëm trafiku publik mund të zhvillohet në formën e trafikut rrugor, hekurudhor, ujqor dhe ajror. Përfitimet nga zhvillimi i tillë i trafikut publik, gjithsesi janë të mëdha. Pra, shoqëria njerëzore me zhvillimin e trafikut publik realisht është zhvilluar edhe në shumë aspekte të tjera, duke filluar nga zhvillimi i madh ekonomik, me një ndikim të drejtpërdrejtë që do të mund të quhej edhe transformim shoqëror, deri te përcjellja më e lehtë e mallrave dhe shërbimeve, komunikimet më efikase në mes të personave fizik dhe juridik, ndërli dhja në mes të shteteve në fusha të ndryshme, lëvizja më e lehtë dhe më e shpejtë e njerëzve nëpër territore të ndryshme etj.

**Fjalë kyç:** *trafikun publik, veprat penale, rrezikshmëria*

---

<sup>1</sup> Autorja është kandidate e studimeve të Doktoraturës (Phd. Cand), në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, si dhe Asistente për grup lëndësh penale në Universitetin Publik të Gjilanit “Kadri Zeka”, Gjilan.

## **Kriza e refugjatëve në Evropë dhe respektimi i të drejtave të refugjatëve**

**Dukagjin LEKA<sup>1</sup>**

dukagjin.leka@aab-edu.net

Të drejtat e njeriut sot janë një prej të drejtave, të cilat në epokën e globalizimit vetëm janë ngritur dhe që në dy dekadat e fundit kanë arritur të relativizojnë edhe aspektin e sovranitetit të shteteve, siç ishte rasti me ish-Jugosllavinë, e raste të tjera në vazhdimësi. Pra, të drejtat e njeriut në aspektin ndërkombëtar kanë arritur që të ngrihen në një piedestal dhe në këtë mënyrë të imponohen si diçka që duhet patjetër të respektohen nga shtetet, sepse në të kundërtën këto të fundit nuk do të mund të bëheshin pjesë e proceseve globale demokratike. Por, në këtë punim shkencor nuk do të shtjellohen të drejtat e njeriut në përgjithësi, por, duke parë që në vitet e fundit kemi kriza të përditshme të refugjatëve, e kam parë të rëndësishme që në këtë punim shkencor të paraqes aspektin e mbrojtjes së të drejtave të refugjatëve, e të cilat të drejta hyjnë në diapazonin e të drejtave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut – pra të drejta që janë të garantuara me të drejtën ndërkombëtare. Por a ndodh realisht në praktikë një mbrojtje e tillë dhe sa me të vërtetë shkelen këto të drejta, e sidomos nga disa shtete anëtare të Unionit Evropian, e cila është kapluar nga një valë e madhe e refugjatëve, dhe se çfarë do të jetë ndikimi i kësaj vale refugjatësh në Evropë do të paraqitet në këtë punim shkencor.

**Fjalë kyç:** *të drejtat e njeriut, globalizimi, sovraniteti, refugjatët, e drejta ndërkombëtare, Unioni Evropian.*

---

<sup>1</sup> Prof. dr. Universiteti i Tiranës, profesor në Kolegjin AAB



# Politika e fqinjësisë së mirë në ballkan dhe perspektiva e Shqipërisë

Anjeza LIÇENJI<sup>1</sup>

l\_anjeza@yahoo.it

”Fqinjësia e mirë” është një parim i marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe një element i teorisë dhe analizës politiko-diplomatike në nivel rajonal (rajonalizmi) apo global (globalizmi), e cila ka qenë një shqetësim i përhershëm për shtetarët, analistët apo opinionin publik. Kuptimi i “fqinjësisë së mirë” është perceptuar ndryshe nga epoka në epokë, me evolucionin e shteteve.

Parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me “fqinjësinë e mirë” dhe të bashkëpunimit miqësor ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, nuk kanë fituar statusin e njëjtë të përparuar, ashtu siç janë ato të marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit, megjithëse edhe kjo është e konceptuar dhe krijuar në të njëjtën cilësi si ato të instrumenteve të mësipërm ndërkombëtar.

Objektiv i rëndësishëm i politikës së jashtme të Shqipërisë ka qenë dhe mbetet politika rajonale. Shqipëria, si një aktor rajonal me një peshë dhe rol gjithnjë e më të rëndësishëm, është e interesuar për një rajon të stabilizuar ku të mbizotërojë paqja dhe bashkëpunimi socio-ekonomik dhe kulturor, si dhe për vendosjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me fqinjët e saj. Marrëdhëniet e “fqinjësisë së mirë” dhe të bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe, veçanërisht, me ato të Ballkanit Perëndimor, vazhdojnë të jenë një nga prioritetet e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, duke qenë njëkohësisht edhe një nga kërkesat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit me BE.

**Fjalë kyç:** *fqinjësi, parim, marrëdhënie, globalizim, MSA.*

---

<sup>1</sup> Phd Candidate, University of Tirana, Civil Law Department

## **Dinamika e përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit në Kosovë 2011-2014**

**Hazir LUSHAJ<sup>1</sup>**

hazir.lushaj@hotmail.com

Kriminaliteti si dukuri sociale komplekse, mund të karakterizohet nga këndvështrime të ndryshme, ndër të cilat me kryesoret janë, vëllimi, struktura, tendencat dhe dinamika e tij. Sjellja kriminale si fenomen individual apo kriminaliteti si dukuri masive, nga pikëpamja shkencore, sot studiohet nga një varg disiplinash të shkencave shoqërore, natyrore dhe humanitare. Debatet të cilat zhvillohen lidhur me sjelljet kriminale dhe kriminalitetin fillojnë nga pikënisjet e ndryshme të argumentimeve shkencore gjë që rezulton me një varg të tërë përkufizimesh të cilat këtë fenomen e analizojnë nga aspekti sociologjik, psikologjik, biologjik, antropologjik, juridik, ekonomik dhe shume aspekte të tjera. Dega e kriminologjisë, e cila është e pandashme nga etiologjia është fenomenologjia, gjegjësisht grupi i studimeve shkencore mbi fenomenologjinë e kriminalitetit. Kështu që kjo sferë e posaçme e kriminologjisë studion dhe analizon format e dukurive, strukturën, paraqitjen strukturale dhe dinamike e kriminalitetit në përgjithësi. Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me strukturën dhe dinamikën e tij. Gjithashtu me trajtimin dhe studimin e kriminalitetit është e domosdoshme të studiohet dhe ndriçohet dinamika e lëvizjes së kriminalitetit në periudha kohore dhe në vende të ndryshme.

**Fjalë kyç:** *kriminaliteti, vëllimi, dinamika, fenomenologjia kriminale.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Universiteti i Sarajevës, Fakulteti per Kriminologji, Studime te Sigurisë

# Sistemi elektoral në Republikën e Maqedonisë

Mersim Maksuti<sup>1</sup>

mersim.maksuti@universitetiaab.com

Fillimisht punimi do të ngërthej historikun e zgjedhjeve pluraliste të mbajtura në Maqedoni që nga pavarësia e saj dhe vendosja e sistemit demokratik pas vitit 1991 dhe gjatë gjithë tranzicionit demokratik deri në ditët e sotme. Duke u nisur nga fakti se zgjedhjet përcaktojnë karakterin e regjimit politik të një vendi, Maqedonia deri me sot ka aplikuar disa sisteme zgjedhore. Fillimisht ka zbatuar sistem mazhoritar në ndarjen e mandateve në parlament pastaj sistem të kombinuar të zgjedhjeve dhe aktualisht zbatohet sistemi proporcional i zgjedhjeve.

Këto reforma të shpeshta në sistemin elektoral të Maqedonisë kanë ardhur si rezultat i pakënaqësisë së opozitës me manipulimet e proceseve zgjedhore që janë mbajtur deri me sot. Pothuajse në çdo legjislaturë të re të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë është zgjedhur me një ligj të ri zgjedhor ose me ndryshime dhe plotësime të ligjit aktual zgjedhor.

Edhe për momentin aktual, në Republikën e Maqedonisë, janë duke u zhvilluira bisedime të mbështetura nga Komisioni Evropian për ndryshim të kodit aktual zgjedhor. Kërkesa për ndryshime të inicuar nga opozita në radhë të parë kanë të bëjnë me numrin e njësive elektorale, çështja e votimit në lista të hapura, vendosja e mekanizmave dhe garancave që sigurojnë pamundësinë e manipulimeve në procesin zgjedhor.

Qëllimi i këtij hulumtimi kërkimor shkencor është që sadopak të jepet një kontribut që nëpërmjet argumenteve shkencore të gjenden modalitete më të mira të sistemit elektoral në Maqedoni duke u mbështetur në faktorët shoqëror politik, piskologjik, vetëdijës së qytetarëve etj.

**Fjalë kyç:** *Demokracia, sistemi elektoral, ndarja e mandateve, kuvendi, komisioni evropian.*

---

<sup>1</sup> Prof.asoc. Mersim Maksuti, Kolegji AAB, Prishtinë.

## **Problemet e procesit të provuarit të veprave penale të vrasjeve në Komunën e Gjilanit për periudhën kohore 1999-2014**

**Reshat Maliqi<sup>1</sup>**

reshatmaliqi60@gmail.com

Nëpërmjet punimit të kësaj teme studimore qëllimi im është të hulumtoj problematikën e procesit të provuarit për veprat penale të vrasjeve në komunën e Gjilanit pas vitit 1999.

Ky punim pasqyron trajtime të hollësishme teorike dhe interpretuese të procesit të provuarit sipas legjislacionit i cili ka qenë në implementim dhe atij aktual procedural penal në Kosovë, bazuar në Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Në parim, tërë aktiviteti i procesit të provuarit i referohet marrjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave si burime të njohjes nëpërmjet të cilave gjykata, duke i vërtetuar faktet e rëndësishme të çështjes penale, vendos për të mirat e individit siç janë liria, nderi, pasuria.

Procesi i të provuarit si objekt ka, të gjitha njoftimet që lidhen me elementët e figurës së veprës penale, marrëdhëniet shoqërore që ka cenuar, koha, vendi, mënyra e kryerjes, rrethanat, pasojën dhe lidhjen shkakësore me të, autorin, bashkëpunimin, rrezikshmërinë, fajësinë dhe formën e fajit, motivet dhe qëllimin në kryerjen e saj dhe çdo gjë që lidhet dhe është në interes të zgjidhjes së drejtë të çështjes penale. Gjatë punës së këtij punimi do të bëj përpjekje që nga statistikat e nxjerra nga policia dhe prokuroria të gjej dhe prezantoj disa nga karakteristikat e përgjithshme dhe të posaçme të cilat kanë qenë pengesë e procesit të provuarit, me të cilat janë ballafaquar institucionet e hetuesisë në Komunën e Gjilanit për periudhën kohore 1999-2014.

Qëllimi i këtij punimi është që të jap një ndihmë jo vetëm për të kuptuar rolin dhe fuqinë e madhe që ka procesi i të provuarit lidhur me provat në luftën kundër krimit, por edhe për t'i identifikuar sa më mirë problemet nëpër të cilat ka kaluar procesi i të provuarit, varësisht prej kushteve dhe rrethanave në të cilën ka ndodhur një vepër penale e vrasjes.

Rëndësia e punimit del në pah duke parë vëmendjen në rritje që po i kushtohet problemit të procesit të provuarit përmes hartimit të legjislacionit përkatës, profesionalizmit të kuadrove, dhe pajisjeve teknike dhe teknologjike bashkëkohore.

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Universiteti i Sarajevës, Fakulteti për Kriminologji, Studime të Sigurisë

Legjislacioni procedural penal paraqet objektin e përbashkët të studimit edhe të drejtës së procedurës penale edhe të kriminalistikës, andaj gjurmimi dhe zbulimi i veprave penale është i pa imagjinueshëm sot pa ndihmën e teknikës kriminalistike (traseologjisë, daktiloskopisë, fotografisë kriminalistike etj), e po ashtu edhe të taktikës dhe metodikës kriminalistike.

**Fjalë kyç:** *procesi i të provuarit, Komuna e Gjilanit, legjislacioni procedural penal, policia, prokuroria, gjykata.*

## **Alkoolizimi si problem social patologjik në rajonin e komunës së Gjilanit - Kosovë**

**Ahmet MALOKU<sup>1</sup>**

ahmet\_maloku@hotmail.com

Alkoolizimi si një problem social patologjik në Komunën e Gjilanit nuk përcjell trendët botërore që janë në rritje. Kohëve të fundit gjithnjë e më shumë po hasen njerëz të cilët nuk janë në gjendje që të përballen me problemet ditore që i bartë shoqëria jonë në tranzicion, pas luftës tash e pesëmbëdhjetë vite disa prej tyre shpëtimin e gjejnë në alkool. Për nevoja të analizës fenomenologjike, kemi ndërmarrë një hulumtim empirik i i cili përfshin strukturën sociale-psikologjike, sociale-demografike të alkoolizimit si problem social patologjik në rajonin e Komunës së Gjilanit, dhe si i tillë përbënë lëndën e këtij punimi në qytetin e Gjilanit. Është për t'u theksuar se përdoruesit e alkoolit nuk degradojnë vetëm individin, por edhe ambientin ku ai jeton, pasi efektet pasqyrohen në të gjitha ambientet ku alkoolisti është pjesë e tij. Andaj, problemet më të shpeshta që lajmërohen si shkak i konsumimit të pakontrolluar të alkoolit me të cilën shoqëria përballet në Komunën e Gjilanit janë dhuna në familje, prishjes së rendit dhe qetësisë publike nën ndikim të alkoolit, vozitja e papërgjegjshme në gjendje të dehur, etj.. Me qëllim të pengimit të rritjes së dukurisë së alkoolizimit në shoqëri duke i vërejtur pasojat negative që ka kjo dukuri në fund të punimit jepem rekomandimet për ndërmarrjen e masave parandaluese për njohjen dhe evitimin e shkaqeve shoqërore dhe individuale që shpien te alkoolizimi.

**Fjalë kyç:** *Alkoolizimit si problem social patologjik, korniza sociale, alkoolizimi dhe kriminaliteti, masat parandaluese.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Kolegji "Gjilani" – Gjilan, Fakulteti Juridik

# Funksionimi i shtetit juridik në Evropën Juglindore me theks të posaçëm në shtetin e Kosovës

Tush Markaj<sup>1</sup>

tushmarkaj@hotmail.com

Funksionimi i shtetit të së drejtës në shtetet e Evropës Juglindore në deceniet e fundit është karakterizuar më një zhvillim dhe prosperitet të theksuar, por gjithsesi niveli i këtij zhvillimi është i ndryshueshëm prej një shteti te shteti tjetër, disa shtete të caktuara ende janë duke u përballur dhe shoqëruar më vështirësi të shumta të cilat janë manifestuar në forma të ndryshme e deri të mosfunksionimi i mirëfilltë dhe i dëshiruar i shtetit juridik. Disa shtete të kësaj pjese të Evropës në 25 vitet e fundit i kanë përcjellë shumë luftëra të përgjakshme[1] për liri dhe pavarësi, kanë ndodhur gjithashtu ndryshime të mëdha në organizimin dhe rregullimin e rendit politik, juridike, ekonomik, social, etj. Periudha e tranzicionit në shumicën e këtyre shteteve është tejkaluar më sukses të larte, duke arritur që disa shtete të integrohen në Bashkimin Evropian[2], disa të tjera janë në faza të avancuara në këtë drejtim. Funksionimi i shtetit juridik garanton respektim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, ofron mundësi të barabarta për të gjithë për zhvillim dhe mirëqenie sociale pa dallim.

Mosfunksionimi i duhur i shtetit ligjor, në shumë fusha ka mundësuar zhvillimin e rritur të kriminalitetit, i cili është manifestuar më fuqizim të disa grupeve të caktuara të cilat kanë përfituar përmes proceseve të privatizimit, krimeve ekonomike, shpëlarjes së parave, etj., të cilat grupe janë duke e penguar dhe vështirësuar zhvillimin ekonomik të shume shteteve të këtij rajoni. Mund të themi së krimi i organizuar është fuqizuar aq shumë sa që është duke kontrolluar shtyllat kryesore shtetërore të shteteve post komuniste dhe atyre në tranzicion, dhe së është krijuar përshtypja se në qoftë se nuk je i lidhur më këto grupe kriminale është e pamundur për të mbijetuar politikisht në këto shtete.

Kosova më një tranzicion të vonuar në krahasim më fqinjët e saj, për shkak të represionit dhe pushtimit të Serbisë gjatë decenies së fundit të shekullit të kaluar dhe luftës për liri dhe pavarësi gjate viteve 1998/99, ka realizuar aspiratat shekullore të popullit të saj, duke u çliruar nga okupatori shumëvjeçar, ka formuar institucionet e saja shtetërore, ka shpallur pavarësinë, por e gjendur si në një oazë në mes të shteteve ku krimi i organizuar është mjaft i theksuar, as kjo nuk ka mbetur immune ndaj këtij fenomeni.

**Fjalë kyç:** *Shteti Juridik , krimi i organizuar , Kosova, Evropa Juglindore*

---

<sup>1</sup> MA, Universiteti i Prishtinës, Juridik-Penal

## **Terrorizmi ndërkombëtar dhe korniza juridike për luftimin e terrorizmit sot**

**Samedin Mehmeti<sup>1</sup>**

**Fatmir Qollakaj<sup>2</sup>**

fatmir.qollakaj@edu-net

Siguria ndërkombëtare dhe ajo globale gjithnjë e më shumë po sfidohen nga terrorizmi bashkëkohor i cili po imponohet si kërcënimi më specifik sot. Bashkësia ndërkombëtare e vetëdijshme për peshën dhe pasojat e këtij kërcënimi ka bërë përpjekje edhe në të kaluarën jo të largët por edhe këto pesë vitet e fundit për një mobilizim gjithë ndërkombëtar për t'u përballur me këtë sfidë dhe për t'u kujdesur që të dobësohet ideologjia terroriste dhe dëmet e pasojat të jenë sa më të vogla e të izoluara. Njëri ndër determinuesit e suksesit të synuar ndërkombëtar në luftë konvencionale kundër terrorizmit bashkëkohor është kuadri apo korniza juridike e harmonizuar ndërkombëtare, parakusht i një strategjie të konsoliduar mirë për luftë të pakompromis ndaj atyre që jetën e akceptojnë si më të voglën vlerë dhe vdekjen si akt i përlogaritur kah amshimi. Korniza juridike ndërkombëtare është relativisht e mjaftuar edhe pse modalitetet më të reja të manifestimit të terrorizmit bashkëkohor kërkojnë plotësim të pjesshëm dhe sforcim të kornizës juridike, por më tepër se kjo, kërkohet konsensus ndërkombëtar politik për parandalim dhe luftim të kësaj të keqeje të përgjithshme. Obstruksionet e nivelit ndërkombëtar, nga disa shtete me ndikim në vendimmarrje në rrafshin ndërkombëtar për interesa të caktuara nacionale, e vështirësojnë dukshëm suksesin e përlogaritit të aleancës apo koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit bashkëkohor sot.

**Fjalë kyç:** *terrorizmi, siguria, sherbimet inteligjente, shteti, ideologjia.*

---

<sup>1</sup> PHD. Candidate: Samedin Mehmeti, ISPE College

<sup>2</sup> PHD. Candidate, Lecturer, AAB College



# **Interpretimi i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ, në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, në rastet e ankimuara nga shtetasit shqiptarë**

**Ilda Mucmataj<sup>1</sup>**

ilda.mucmata@fdut.edu.al

Njohja dhe garantimi i të drejtës së pronës përbën një ndër çështjet më thelbësore për krijimin e stabilitetit në një shoqëri demokratike. Kjo e drejtë bën pjesë në kategorinë më të rëndësishme ekonomike dhe juridike të rregulluar nga legjislacionet shtetërore duke filluar që nga lashtësia dhe deri në ditët e sotme. Aktualisht e drejta e pronës në Shqipëri disiplinohet dhe garantohet nga akte juridike kombëtare dhe ndërkombëtare të një rëndësie të lartë dhe përbën një nga çështjet që shfaq një problematikë të lartë praktike.

Si rezultat i ndjeshmërisë të subjekteve për kufizimin dhe shkeljen e gëzimit të kësaj të drejte reale, si dhe duke mbajtur në konsideratë që pjesa më e madhe e çështjeve që janë paraqitur nga shtetasit shqiptarë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, kanë të bëjnë me pretendimet e shkeljes të nenit 1 të Protokollit 1, gjatë procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, pamë me interes studimin e interpretimeve që kjo gjykatë ka bërë në lidhje me këtë problem.

**Fjalë kyç:** *pronat, krijimi i stabilitetit, legjislacionet shtetërore*

---

<sup>1</sup> Phd Candidate, Universiteti i Tiranës, Departamenti Civil, Fakulteti i Drejtësisë

# **Djeca u fokusu kriminoloških istraživanja**

## **(Etički kodeks istraživanja o djeci i sa djecom u Bosni i Hercegovini)**

**Elmedin Muratbegović<sup>1</sup>**

emuratbegovic@fkn.unsa.ba

Stalna potreba za istraživanjem novog, s jedne strane, te imperativ za zaštitu djeteta od bilo koje vrste zloupotrebe, s druge strane, razlozi su zbog kojih je neophodno razviti deontološki etičke standarde istraživanja koja se odnose na djecu uopće. U okviru ovog Etičkog kodeksa, praktično se direktno primjenjuju standardi utvrđeni u okviru Ustava Bosne i Hercegovine, člana II) Ljudska prava i osnovne slobode, a koji su utemeljeni na međunarodnim standardima za zaštitu djece utvrđenih, prije svega, UN Konvencijom o pravima djeteta (iz 1989.), ali i drugim UN i evropskim konvencijama i protokolima koje je ratifikovala Bosna i Hercegovina, a koje se odnose na zaštitu i prava djece.

Pitanja koja uređuje Etički kodeks istraživanja sa djecom i o djeci u Bosni i Hercegovini, tiču se statusa samog djeteta i njegove porodice kao učesnika u istraživačkom procesu humanističkih, društvenih, obrazovnih, medicinskih i ostalih naučnih i stručnih istraživanja. Posebna pažnja posvećena je prevenciji uzroka, i uopćeno situacija u kojima može postati upitan integritet samog djeteta. Etičkim kodeksom se uređuju prava i obaveze, te odgovornosti istraživača. Etičkim kodeksom se utvrđuju pravila ponašanja istraživača i etička načela na osnovu kojih istraživači postupaju, prilikom obavljanja naučnih, medijskih, sportskih, sudskih i uopćeno stručnih istraživanja, a koja u fokus svojih interesovanja stavljaju dijete. Etički kodeks se primjenjuje na sve vrste istraživanja u kojima su aktivni učesnici djeca, ili koja se odnose na djecu. Ovaj dokument treba biti konsultovan od strane svih zakona i strukovnih kodeksa koja se, sa različitih aspekata, tokom istraživanja, bave pitanjima koja su od interesa za djecu. Etički kodeks treba poslužiti kao osnova za proširenje pomenutih strukovnih kodeksa sa zahtjevima iz ovog Etičkog kodeksa. U skladu sa UN Konvencijom o pravima djeteta, ovaj Etički kodeks se odnosi na djecu mlađu od 18 godina.

Osnovno pitanje koje se uređuje ovim Etičkim kodeksom jeste status djece učesnika u različitim istraživanjima, koja na neposredan ili posredan način mogu uticati na integritet ličnosti djeteta. Etički kodeks definiše primjenu zahtjeva iz UN Konvencije o pravima djeteta, te osiguranja odgovarajuće zaštite prava djeteta kao

---

<sup>1</sup> Prof. dr., Vanredni profesor; Univerzitet u Sarajevu – Bosna i Hercegovina; Šef Katedre za kriminologiju

što su: pravo nediskriminacije djece (čl. 2.); zaštita najboljeg interesa djeteta (čl. 3.); pravo djeteta na izražavanje vlastitog mišljenja u stvarima koje ga se tiču, te njegovo uvažavanje u skladu s dobi i zrelosti djeteta (čl. 12.); pravo na slobodu izražavanja (čl. 13.); pravo na slobodu misli i savjesti (čl. 14.); pravo na zaštitu privatnosti, prepiske, ugleda i časti (čl. 16.), te pravo na pristup obavijestima i materijalima radi promocije djetetove dobrobiti i zdravlja (čl.17.), na način da se status djeteta utvrđuje: poštujući pravo djeteta na odlučivanje u istraživanju, odn. njegov/njen pristanak na istraživanje, sopstveno mišljenje o istraživanju, kao i pravo na odustajanje od istraživanja u bilo kojem trenutku;osiguravajući čuvanje identiteta djeteta, njegove porodice i grupe kojoj pripada;precizirajući uslove za omogućavanje uvida u rezultate istraživanja.Etički kodeks definiše status roditelja/staratelja, s obzirom da se i na njih, kao učesnike procesa istraživanja, odnose standardi utvrđeni u okviru ovog Etičkog kodeksa, na način da se:status roditelja/staratelja, uvažavajući pojedina prava djeteta, uređuje u svim fazama istraživanja;osiguravajući da roditelj/staratelj ima pravo na pravovremenu informisanost o samom istraživanju i rezultatima istraživanja;roditelj/staratelj daje pristanak da dijete učestvuje u istraživanju ili da se istražuje o djetetu.Status istraživača je Etičkim kodeskom preciziran na način da:su detaljno utvrđena njegova/njena prava i obaveze, kao i procedura omogućavanja uvida drugim licima u rezultate istraživanja, uz obaveznu zaštitu podataka o ličnosti djeteta i njegove porodice; istraživač je dužan, za specifično istraživanje za koje traži dozvolu, pokušati predvidjeti moguće etičke dileme za koje bi dao potencijalna rješenja, te ih kao takve, u fazi traženja dozvole poslati Etičkom tijelu na uvid.

**Ključne riječi:** *djeca, etika, istraživanja, najbolji interes djeteta.*

## **Marrëveshjet paqësore dhe të drejtat e njeriut: rasti i Maqedonisë**

**Ali MUSLIU<sup>1</sup>**

musliu.ali@gmail.com

Ekziston lidhje e pandërprerë mes idesë për të drejtat e njeriut dhe marrëveshjeve paqësore. Duke ndjekur gjerësinë dhe kompleksitetin e të drejtave të njeriut, ky punim analizon konceptin e të drejtave të njeriut dhe Marrëveshjen paqësore në Republikën e Maqedonisë që nga viti 2001. Analizë të veçantë i kushtohet Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në sferë të zgjidhjes së konfliktit si dhe derivimi i ndryshimeve kushtetuese të 2001, si dhe sfidat perspektivat aktuale. Punimi fokusohet në tri çështje kryesore, analizë e procesit që rezultoi me sukses/dështim në zgjidhjen e konfliktit në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu bëhen krahasime empirike të procesit në nivel nacional që nga viti 2001, dhe ndërvarësia e marrëveshjes paqësore dhe të drejtave të njeriut në Maqedoni. Në fund punimi përqendrohet në orvatjen e transformimin e sistemit të të drejtave të njeriut në Maqedoni, nga një koncept ideal retorik në një vegël konkrete e zgjidhjes së konflikteve në nivel nacional. Çështja e të drejtave të njeriut dhe bashkërendimit të qëndrueshëm janë një nga faktorët sfidues të Maqedonisë në integrimin e saj në Union Evropian.

**Fjalë kyç:** *të drejtat e njeriut, marrëveshje paqësore, transformim, faktorë sfidues.*

---

<sup>1</sup> Dr. Universiteti i Tetoves, ligjerues në Kolegjin AAB

# **Pranimi i përgjegjësisë penale të personave juridikë në vendet e Evropës Juglindore - zgjedhja e ligjvënësit në Kosovë**

**Avni PUKA<sup>1</sup>**

av.puka@gmail.com

Çështja e përgjegjësisë penale të personave juridikë, është një koncept që është ngritur në mbarë botën, si rezultat i ndikimit në rritje të personave juridikë, në të gjitha fushat e jetës sociale dhe ekonomike, duke bërë të mundur edhe kryerjen e shumë veprave penale në emër dhe dobi të tyre.

Pas një tradite të gjatë në sistemin "Common Law", në dekadat e fundit përgjegjësia penale e personave juridikë është pranuar gjerësisht edhe në vendet që janë pjesë e sistemit "Civil law", si një përgjigje ndaj nevojës për t'u mbrojtur nga krimet e korporatave. Ky trend ka ekzistuar edhe në vendet e Evropës Juglindore drejt rregullimit të një përgjegjësie të tillë (Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Serbia, Kroacia, etj).

Në këtë punim, do të analizohen në aspektin krahasues zgjidhjet ligjore në vendet e Evropës Juglindore. Në veçanti, do të trajtoj aspektet kryesore të përgjegjësisë penale të personave juridikë në Republikën e Kosovës.

**Fjalë kyç:** *person juridik, përgjegjësia penale, person fizik, compliance program.*

---

<sup>1</sup> Phd Candidate, University of Prishtina, Criminal Law Department

# **Ndryshimet e Ligjit të Procedurës penale të Republikës së Maqedonisë dhe roli i tyre në funksionimin e shtetit juridik**

**Vedije Ratkoceri<sup>1</sup>**

v.ratkoceri@seeu.edu.mk

**Blerta Arifi**

Në këtë punim autorët do të analizojnë ndryshimet e fundit (të vitit 2010) dhe risitë që solli Ligji i Procedurës penale në Republikën e Maqedonisë si dhe roli i këtyre ndryshimeve në funksionimin e shtetit juridik.

Jemi përcaktuar për këtë temë sepse bëhet fjalë për një ndryshim mjaft voluminoz si dhe esencial ku shumë çështje thelbësore të procedurës penale kanë ndryshuar dhe mendojmë se do të kenë impakt të konsiderueshëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të punës së organeve të drejtësisë.

Autorët do të mundohen të bëjnë një analizë të neneve përkatëse që kanë ndryshuar, do të shqyrtojnë risitë e miratuara një nga një si - futja e policisë gjyqësore, heqja e gjyqtarit hetues, funksioni i ri i prokurorit publik, raporti i ri midis policisë dhe prokurorit publik, heqja e paditësit subsidiar e kështu me radhë.

Pa dyshim, ky punim do të ketë edhe një qasje krahasuese, duke bërë krahasimin e dispozitave ligjore të vjetra dhe atyre të reja që kanë hyrë në fuqi, do të mundohemi të vëmë në pah mangësitë dhe çështjet që janë më delikate dhe që dyshojmë se do të mund të zbatohen në formën e duhur në vendin tonë.

Vend të rëndësishëm në këtë punim do të ketë edhe vështrimi ynë lidhur me ndikimin e këtyre ndryshimeve në mbarëvajtjen dhe funksionimin e shtetit juridik, ligjor dhe në aspekt të sigurisë shtetërore.

Besojmë dhe shpresojmë që punimi jonë të jep një kontribut shkencor të rëndësishëm në ndriçimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e shtetit juridik dhe ligjor.

**Fjalë kyç:** *ndryshimi i ligjit funksionimi i shtetit juridik, policia gjyqësore, roli i prokurorit publik.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, South East European University, Law Faculty

## Osnovne karakteristike prestupništva mladih na području grada Prizrena

Ferdi Redzepi<sup>1</sup>

ferdi\_pz15@hotmail.com

Prestupničko ponašanje mladih, odnosno asocijalno, antisocijalno, antidruštveno tj. društveno-neprihvatljivo ponašanje predstavlja poremećaj ponašanja kojim se direktno krše moralne i pravne norme određene društvene zajednice, i kao takvo podrazumijeva izvršenje krivičnih djela (protiv imovine, života, tijela i dr.), prekršaja (saobraćajnih, protiv javnog reda i mira i dr.) i nemoralnih radnji i postupaka (agresivno-nasilničko ponašanje, bježanje iz škole, bježanje od kuće i dr.). Stručnjaci različitih znanstvenih područja pokušavaju naći odgovor zašto neka djeca i mladi koji su izloženi rizičnim ponašanjima ne usvajaju rizično ponašanje, za razliku od drugih koji se nalaze u istim ili sličnim okolnostima, koji im ne podliježu. Prestupničko ponašanje mladih i odraslih potrebno je razmatrati sa različitog aspekta počevši od osobnih crta ličnosti, kulturnog konteksta, socijalno-ekonomskog sistema, obrazovanja, stigmatizacije i drugih faktora. U razdoblju mladenaštva mladi često eksperimentiraju s raznim ponašanjima, a percepcija mladih od strane drugih može otežati njihovu uspješnu integraciju u društvo.

Ovaj rad će nam predočiti najznačajnije teorijske implikacije koje se tiču prestupničkog ponašanja mladih, kao i empirijski dio istraživanja u gradu Prizrenu o osnovnim karakteristikama i stepenu zastupljenosti prestupničkog ponašanja mladih. U radu su prikazani i analizirana prijavljena krivična djela u MUP-u Prizrena, počinjena od strane mladih u periodu od 2003. do 2012. godine, kao i zapažanja nastavnika osnovnih i srednjih škola, odgajatelja maloljetničkog doma za prevaspitanje o rizičnim ponašanjima djece i mladih, problemskim područjima i aktivnostima na planu primarne prevencije kao i saradnja sa roditeljima. Također, u istraživanju su korišćene tehnike ispitivanja strukturirani intervjui i konstruirani anketni upitnik, primjenjen na uzorku od oko 591 ispitanika, učenika osnovnih i srednjih škola, studenata Univerziteta u Prizrenu i maloljetnika koji su pod nadzorom Centra za socijalni rad. U ispitivanju je korišten upitnik za procjenu doživljaja stigmatizacije, Offerov upitnik samopoimanja i Coopersmithov upitnik samopoštovanja, socio-demografski upitnik, kao i konstruisani upitnik za mišljenje studenata o prestupničkom ponašanju mladih u Prizrenu. Podaci su obrađeni u programskom paketu SPSS.

---

<sup>1</sup> MA, Fakultet za kriminalistiku, kriminologiju i sigurnosne studije, Univerzitet u Sarajevu

Rezultati istraživanja ukazuju na mnoštvo problema u području odgoja i obrazovanja koje je nužno istražiti te preduzeti širu društvenu akciju za njihovo rješavanje. Također, prestupničko ponašanje mladih je dosta izraženo u strukturi prijavljenih krivičnih djela u Prizrenu, čak su ispitanici sugerirali na neke oblike krivičnih djela koja nisu u većem obimu zastupljena u strukturi prijavljenih i registriranih krivičnih djela, dakle, to podrazumijeva zastupljenost tamne brojke kriminaliteta mladih. Društvo ne preduzima sve neophodne mjere u cilju spriječavanja prestupničkog ponašanja mladih, bez obzira što su roditelji, studenti, nastavnici i drugi svjesni za sve izraženiji problem prestupništva mladih ljudi.

**Ključne riječi:** *mladi, stigmatizaranost, delinkvencija, maloljetnici, asocijalnost, prestupništvo, učenici, ponašanje*



## Fenomeni i vetvrasjes ne regjionin e Ferizait

**Qazim Reka<sup>1</sup>**

qazim.reka@hotmail.com

Formulimi i konceptit të vetvrasjes si një akt fatal që paraqet zgjedhjen e personit për të vdekur, duket jo i plotë. Kjo për shkak të kompleksi tetit të temës dhe dallimeve në recepcionin në lidhje me jetën dhe vdekjen. Përballja me situata të panjohura na bën të ndihemi ndryshe. Nëse kjo përballje paraqet rrezik potencial për të cenuar vazhdimësinë e rutinës jetësore, manifestimi i ndjenjave dominohet me frikën. Në momentin kur kuptojmë më shumë nëpërmes informatave, ne mund të racionalizojmë dhe të gjejmë shpjegimin e fenomeneve dhe të reduktojmë ndjenjën e frikës. Ndërkaq vdekja, mbetet fenomen i pasqaruar në aspektin e kuptimit. Prandaj, mbetet në nivel të drojës, shpresës, lutjeve, mëshirës, pamundësisë për ta injoruar. Në këtë kuadër, njeriu ka predispozita të provojë të ikë nga ajo që nuk i gjen kuptim dhe t'i kthehet më shumë gjetjes së kuptimit të jetës.

Në opinionin e gjerë duhet bërë të ditur së akti i vetvrasjes nuk përkon me kulturën tonë, në opinion dhe në media vetvrasja duhet trajtuar në mënyrë të veçantë për pasojat që lë në shoqërinë tonë, dhe të trajtohet si akt qyqar e jo si zgjedhje e problemeve, gjë që do të ndikonte që shoqëria jonë të largohet nga ky fenomen dhe të kemi një shoqëri të shëndoshë.

Dhjetë shtatori është Dita botërore e parandalimit të vetvrasjes. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) në botë një tentim vetvrasjeje ndodh në çdo tre sekonda dhe se në çdo minutë ndodh një vetvrasje. Sipas vlerësimit të OBSh-së rezulton se më shumë njerëz vdesin me vetvrasje sesa në konflikte të armatosura.

**Fjalë kyç:** *Fenomen, Vetvrasje, Vdekja, masat parandaluse*

---

<sup>1</sup> Msc., Ass.Ligjerues BPrAL Kolegji AAB

## **Terrorizmi si kërcënim ndaj rëndit evropian dhe atij global**

**Fatmir RRAHMANAJ<sup>1</sup>**

fatmir\_rrahmanaj@live.com

Në këtë punim do të bëjmë fjalë për terrorizmin si kërcënim global . Aktualisht në Rendi e Ri Botëror ekzistojnë nocione të reja që kanë hyrë në fushën e sigurisë siç është edhe terrorizmi. Terrorizmi si nocion dhe si veprimtari është definuar në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Si nocion, historikisht është përdorur gjatë Revolucionit Borgjez Francez, në kuptimin e dënimeve të shqiptuara nga gjykatat revolucionare kundër armiqve të republikës. Fjala terrorizëm rrjedh nga fjala latine “terror” e cila nënkupton tmerrin, trishtimin, shkaktimin e frikës dhe dridhjes, dhunës politike deri tek shkatërrimi fizik i kundërshtarit.

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, dalja në skenë e disa koncepteve që më parë nuk ekzistonin, ose ishin në një nivel me të ulët, ndryshuan pozicion duke u shndërruar në një prej kërcënimeve kryesore në mbarë botën. Kjo u bë shkas që i detyroi shtetet të rishikonin mekanizmat e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit dhe sulmit ndaj kullave binjake në New York u dëshmuua se tashmë asnjë shtet në botë nuk është i sigurt, duke përfshirë edhe ato që pretendojnë se kanë krijuar një sistem modern mbrojtës.

Prandaj në ditë tona, sfidë për shtetet dhe organizatat ndërkombëtare vazhdon të mbetet identifikimi i terroristëve, mjetet që posedojnë, ku, kur dhe si do të godasin.

**Fjalë kyç:** *terrorizmi, siguria, kërcënim, kombëtar, ndërkombëtar.*

---

<sup>1</sup> Ma, Universiteti i Prishtinës

# Aspekte të gjykimit pilot në çështjet e pronësisë: rasti i Shqipërisë

Nadia RUST<sup>1</sup>

nrusi@hotmail.com

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut po përballet me një numër të madh çështjesh të dërguara nga më shumë se 800 milionë aplikime nga 47 palët kontraktuese. Vetëm në fund të gjashtëmujorit të parë të 2015, pothuajse 64000 çështje prisnin për t'u gjykuar nga GJEDNJ. Nga këto, të ashtuquajturat “çështje të përsëritura” për shkak të problemeve strukturore në nivel kombëtar, po zënë një pjesë gjithmonë e më të madhe në numrin total të gjyqimeve në pritje.

Ky punim ka për qëllim të analizojë procedurën e gjykimit pilot, si një risi e procedurës së gjykimit përballë rritjes së numrit të aplikimeve të përsëritura nga palët kontraktuese. Punimi do të tregojë se aplikimi i kësaj procedure e lejon gjykatën së pari: të identifikojë problemet strukturore apo sistematike të legjislacionit kombëtar dhe së dyti të përcaktojë masat e përgjithshme që duhet të merren nga shtetet në mënyrë që rastet e ngjashme në të ardhmen të mund të zgjidhen që në nivel kombëtar.

Fokus i veçantë i punimit do të jenë problemet strukturore të normave juridike të pronësisë në legjislacionin shqiptar dhe mundësia për aplikimin e procedurës së gjykimit pilot për adresimin e tyre. Përmes analizës së jurisprudencës së GJEDNJ në çështjet shqiptare do të tregojmë efektivitetin dhe sfidat e aplikimit të kësaj procedure në mbrojtjen e të drejtës së pronësisë në Shqipëri.

**Fjalë kyç:** gjykimi, palët kontraktuese, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut etj.

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë

## **Nevoja për unifikim dhe harmonizim të së drejtës kontraktuese ndërkombëtare**

**Faton Shabani<sup>1</sup>**

faton.shabani@unite.edu.mk

Ndërkombëtarizimi i tregtisë gjatë shekullit XX ka ngritur çështjen se si tregtia e tillë mund të realizohet në mënyrën më efikase. Tregtia ndërkombëtare historikisht ka qenë objekt i një numri të madh të sistemeve ligjore, kryesisht në bazë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private. Llojlojshmëria e tillë ligjore krijonte pasiguri juridike dhe impononte shpenzime plotësuese për palët në transaksionet ndërkombëtare. Përcaktimi për të hequr pengesat e paraqitura në tregtinë ndërkombëtare çoi në shtytje për një parashikueshmëri më të madhe në lidhje me të drejtën e zbatueshme në këto transaksione. U pranua botërisht që rreziqet ligjore dhe shpenzimet do të zvogëloheshin nëse do të kishte një ligj apo një grup të rregullave që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkombëtare. Ishte e pashmangshme ideja të mendohet seriozisht në lidhje me procesin e unifikimit ose harmonizimit të së drejtës kontraktuese ndërkombëtare. Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë pasqyrë të procesit të unifikimit dhe harmonizimit, respektivisht të shqyrtojë iniciativat që kanë për qëllim realizimin e këtyre proceseve, duke filluar me Konventat e Hagës, Konventën e Kombeve të Bashkuara për shitjen ndërkombëtare të mallrave, parimet e UNIDROIT për kontratat tregtare ndërkombëtare, Parimet e së drejtës kontraktore evropiane dhe përpjekjet për një kod civil evropian.

**Fjalë kyç:** *tregtia ndërkombëtare, unifikimi, harmonizimi.*

---

<sup>1</sup> PhDc, Faculty of Law, State University of Tetova

# Drejtesia elektorale në Kosovë

## (Zbatimi i të drejtës zgjedhore)

**Xhavit Shala<sup>1</sup>**

xhavitshala@gmail.com

Në këtë punim do të trajtohet drejtësia elektorale në Kosovë, në fokus të veçantë do jetë realizimi i se drejtës zgjedhore në procesin ankimor; sanksionet dhe ndëshkimet e mashtrimeve elektorale gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet lokale dhe nacionale.

Qëllimi i këtij hulumtim është gjetja e përgjegjës në pyetjet si: Çfarë është drejtësia zgjedhore? Çfarë sanksionesh ligjore janë paraparë për secilin krim elektorale? Çfarë veprimesh duhet të bëjë një person fizik apo juridik kur pretendon që i janë cenuar të drejtat e tyre elektorale? Cili institucion është kompetent për të dhënë drejtësinë elektorale? Cilat janë mënyrat për të rivendosur drejtësinë elektorale?

Ky hulumtim do të merret me: analizën e kornizës ligjore që garanton një proces të drejtë elektorale, raportet e institucioneve kompetente për vendosjen e drejtësisë elektorale, trajtimin e rasteve të mashtrimeve në zgjedhje dhe procesin ankimor në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa si dhe ndëshkimet nga prokuroria dhe gjykatat për krimet elektorale gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet lokale dhe nacionale.

Arritja e një konsensusi politik për një reformë ligjore dhe institucionale në Kosovë do t'i zvogëlonte ( parandalonte) mundësitë për abuzim gjatë procesit zgjedhor. Rritja e besimit dhe ngritja e kapaciteteve institucionale për të vënë drejtësinë çdo herë kur pretendohet se është cenuar e drejta e votës paraqet siguri për qytetarin dhe garanci për stabilitetin institucional. Siguria në realizmin e së drejtës së votës dhe leximi i drejtë i vullnetit të popullit do të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe plotësimin e standardeve të pranuar ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike gjatë proceseve zgjedhore në Kosovë.

**Fjalë kyç:** *drejtësi elektorale, e drejta e votës, krim elektorale, procesi ankimor*

---

<sup>1</sup> PhD CAND, Universiteti Evropian i Tiranës, E drejta Publike

## **Shqyrtimi krahasimor i analizës statistikore për refuzimin e kallëzimeve penale në Republikën e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës**

**Marijan Šuperina<sup>1</sup>**

msuperina@net.hr

**Driton Muharemi<sup>2</sup>**

driton.muharremi@aab-edu.net

**Nedžad Korajlić<sup>3</sup>**

dean@fkn.unsa.ba

Në artikull analizohen në mënyrë krahasimore të dhënat statistikore të kallëzimeve të refuzuara penale të policisë nga prokurori i shtetit në Republikën e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës, në periudhën kohore prej vitit 2008 deri në vitin 2012. Në hyrje jepet një pasqyrë e shkurtër krahasimore e bazës ligjore për nxjerrjen e aktvendimit për refuzimin e kallëzimit penal të policisë sipas ligjeve për procedurat penale të dy shteteve. Vëmendje më e madhe iu ka kushtuar arsyeve joligjore (të brendshme dhe të jashtme) që ndikojnë në: a) paraqitjen e kallëzimit penal prokurorit të shtetit, dhe b) në nxjerrjen e vendimit për refuzimin e kallëzimit penal; që ekzistojnë në anën e punonjësve të policisë dhe të prokurorit të shtetit në përbërje të ndjekjes penale. Në vazhdim analizohen të dhënat statistikore lidhur me kallëzimet e refuzuara penale në Republikën e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës, në mënyrë që të përcaktohet struktura themelore e vetë refuzimeve të kallëzimeve penale në raport me numrin e përgjithshëm të personave të paraqitur për veprë penale. Përfundimisht, nxirren përfundimet lidhur me analizën e bërë statistikore të kallëzimeve të refuzuara penale në të dy shtetet. Gjithashtu duke iu referuar nevojës për hulumtime të mëtejme të vetë arsyeve ligjore për refuzimin e kallëzimeve penale, posaçërisht të arsyeve ligjore: a) të mos ekzistimit të veprës penale dhe b) të mos ekzistimit të dyshimit të bazuar ose të provave për kryerjen e veprës penale.

**Fjalë kyç:** *kallëzimi penal, policia, prokuroria e shtetit, ndjekja penale, hedhja e kallëzimit penal.*

---

<sup>1</sup> M. Sc Doktorant në Fakultetin e Kriminalistikës, Kriminologjisë dhe Studimeve të Sigurisë, Universiteti i Sarajevës

<sup>2</sup> Dr.sc.Ligjerues në Kolegjin AAB në Prishtinë, Republika e Kosovës

<sup>3</sup> Prof. dr.Dekan në Fakultetin e Kriminalistikës, Kriminologjisë dhe Studimeve të Sigurisë, Universiteti i Sarajevës

## Migrimi i pa rregullt në Kosovë 2009-2013

Rrahman SYLEJMANI<sup>1</sup>

rrahmansylejmani@gmail.com

Republika e Kosovës gjatë historisë së saj është ballafaquar me fenomenin e migrimëve si para luftës së fundit (1998-1999), ashtu dhe pas luftës. Gjatë periudhës kohore deri në vitin 1999 deri në përfundimin e luftës së fundit ka qenë prezent migrimi i qytetarëve tanë kryesisht nga arsyeja politike si rezultat i represionit të regjimit dhe pushtetit të atëhershëm. Edhe në periodën e pasluftës pas vitit 1999 deri në kohën e sotme, Kosova ballafaqohet edhe më tutje me fenomenin e migrimit dhe atë të qytetarëve tanë, mirëpo nga shkaqet krejtësisht tjera e ato janë kryesisht nga shkakut social-ekonomik.

Territori i Republikës së Kosovës gjithashtu shfrytëzohet si vend transit për shkuarje drejt Shteteve të Bashkësisë Evropiane nga ana e shtetasve të huajë të shteteve të treta, kryesisht nga kontinenti i Azisë dhe Afrikës.

Qëllimi i këtij punimi është që të identifikohen dhe analizohen rrjedhat e lëvizjeve migruese gjatë periudhës kohore nga viti 2009-2013 si dhe aktivitetet e strukturave të Policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës në trajtimin e kësaj dukurie. Si metodë e përpilimit të këtij punimi është shfrytëzuar dhe analizuar literatura, dokumente strategjike si dhe të dhëna empirike nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm MPB dhe PK) për periudhën e viteve 2009-2013.

Gjatë viteve të 90-ta, posaçërisht 1998-1999, kanë emigruar 51.728 qytetarë të Kosovës. Ky trend nuk është zvogëluar as pas periudhës së pasluftës, kështu që në periodën kohore 2011-2013 janë regjistruar gjithsejtë 54.644 qytetarë të Kosovës me leje qëndrim në shtetet e BE-së.

Duke u bazuar në këto të dhëna, mund të konkludohet se ky trend i migrimëve të përgjithshme në Kosovë edhe më tej është në rritje përveç se dallojnë vetëm shkaktarët të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e tij duke kaluar nga shkaktarët politikë në socio-ekonomikë.

Sa i përket qëndrimit të të huajve në Kosovë dhe lëshimit të lejeve të përkohshme për qëndrimin e tyre për vitin 2013 janë regjistruar gjithsejtë 2078 kërkesa, e që do të thotë se janë për 20% më shumë në krahasim me vitin 2011.

**Fjalë kyç:** *migrimi, Kosova, shtetasit, Bashkësia Evropiane, të dhënat, motivi, qëndrimi i përkohshëm.*

---

<sup>1</sup> PhD candidate, Universiteti i Sarajevës, Fakulteti për Kriminologji, Studime të Sigurisë

## **E drejta për kthim e popullsisë shqiptare në Greqi nën hijen e legjislacionit grek dhe të së drejtës ndërkombëtare**

**Mentor Tahiri<sup>1</sup>**

mentor.m.tahiri@gmail.com

E Drejta Ndërkombëtare është në një garë të vazhdueshme me traktatet ndërkombëtare si dhe ligjet e shteteve që kanë përligjur migrimin e dhunshëm. Në rastin e Traktatit të Llozanës, dy shtetet e involvuara, Greqia dhe Turqia, në cilësinë e rolit paternalist janë “përkujdesur” për popullsitë. Traktati i Llozanës në këtë aspekt madje është cilësuar edhe si humanitar ngase i ka mundësuar popullsi të jetojnë brenda territorit ku qeverisë i njëjti popull.

Çështja që shtrohet nga këndvështrimi i sotëm, trajton më tepër fatet individuale, ajo nuk merret me rrethanat politike të kohës dhe as me mbulimin ligjor që shtetet i kanë bërë depërtimit të popullsi. Mbetet sfidë e cila do të sprovohet në të ardhmen për të parë se si reagojnë autoritetet në rastin e kërkesave të mundshme për rikthimin e pronave nga ana e trashëgimtarëve familjarë të pronarëve të mëparshëm. Këtu e Drejta Ndërkombëtare tani më është në garë me kohën.

Në historikun e konteksteve Greko-Turke zhvendosjet nuk kanë përfunduar me traktatin e Llozanës, ato janë finalizuar shumë më vonë me ndarjen e ishullit të Qipros në dy njësi politike. Në rastin e Qipros nuk ka një traktat të nënshkruar për zhvendosjen e popullsi por duket se palët kanë një pajtim të heshtur në lidhje me këtë. Sidoqoftë kur bëhet fjalë për dëbimin e shqiptarëve, Greqia vulosi fatin e tyre përfundimisht pas Luftës së Dytë Botërore, me spastrimin etnik të Çamërisë.

Cila është perspektiva e kthimit? Kjo çështje do të trajtohet nën hijen e të mundshmes që ofron politika, legjislacioni në fuqi dhe e drejta ndërkombëtare. Me nocionin “kthim”, këtu nuk mendohet në kthimin fizik, por sidomos aludohet në kthimin e pronave, si në një proces mjaft të ndjeshëm.

**Fjalë kyç:** *legjislacioni, migrimi, territori, e drejta ndërkombëtare*

---

<sup>1</sup> MA. Kolegji Victory, International Politics and Diplomacy



# Mjetet edukative të nxënësve në shkollë, në veçanti mjetet e motivimit dhe ndikimi i tyre në parandalimin e sjelljes së dhunshme në shkollë

**Bujar THAQI<sup>1</sup>**

bujar.thaqi@rks-gov.net

Për mosshfaqjen e dhunës në shkolla nga ana e nxënësve, po edhe nga personat e tjerë të rritur, është e interesuar jo vetëm familja e shkolla, por edhe shkencëtarët dhe e gjithë shoqëria. Parandalimi sa më parë i dhunës në shkolla, është jo vetëm nevojë e praktikës, por edhe interes i shkencës dhe shoqërisë demokratike e të lirë, në kuptimin e plotë të fjalës. Prandaj synimi dhe interesi i shoqërisë është që ta edukojë rininë për një jetë dhe punë të ardhme në shoqëri dhe për shoqërinë. Kuptohet, shoqëritë e përparuara i kanë të hapura dyert e përparimit, dhe ato kanë arritur atje ku janë sot në saje të edukimit dhe arsimit të drejtë institucional, e jo me presion, shtypje dhe dhunë.

Prandaj, shoqëria me mekanizmat që i ka në dispozicion duhet të bëjë çmos që të mos lejojë të përhapet dhuna në shkolla.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të konstatojmë se cilat janë mjetet edukative, në veçanti mjetet e motivimit të cilat më së shumti nxënë vende në shkollë, mënyrat e përdorimit të këtyre mjeteve dhe ndikimin e tyre në zvogëlimin dhe parandalimin e sjelljes së dhunshme të nxënësve në shkollë.

Objekti kryesor i këtij studimi dhe i hulumtimit, është përdorimi i mjeteve edukative, në veçanti i mjeteve të motivimit dhe ndikimi i tyre në mbarëvajtjen e punës mësimore.

Në punën tonë vend kryesor do të zë: konsultimi i literaturës, përpilimi dhe zbatimi i pyetësorit, interpretimi i rezultateve.

Metodat e hulumtimit: Metoda e analizës teorike, e dokumentacionit pedagogjik-social, statistikore, e bisedës dhe e krahasimit të të dhënave.

**Fjalë kyç:** *shkolla, nxënë, arsimtar, prindër, mjete, motivim.*

---

<sup>1</sup> Phd Candidate, Universiteti i Tiranës

## **Gjenerata e tretë e të Drejtave të Njeriut në Kosovë dhe diskriminimi pozitiv**

**Bashkim Rrahmani<sup>1</sup>**

bashkimrrah@yahoo.com

**Majlinda Belegu<sup>2</sup>**

lindatergita@yahoo.com

**Veton Vula<sup>3</sup>**

vetonvula@gmail.com

Të Drejtat e Njeriut në Kosovë në kupitmin formalo juridik janë të parapara me Kushtetutën e Kosovës, në brendësi të të cilës janë të inkuorporuara dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare duke filluar nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e deri të Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Por pavarësisht nga kjo, janë disa çështje të cilat mbesin akoma në nivel të debateve politike dhe projeksioneve për të ardhmen sikundër që janë disa çështje që tejkalojnë nivelin e debatit akademik dhe teorik, duke marrë një dimension që tejkalon fushën e të Drejtave të njeriut. Dhe ky dimension nga këndvështrimi praktik, ka mundësi të tejkalojë atë që është e pranuar si diskriminim pozitiv në momente dhe në vende të caktuara. E drejta në zhvillim, e drejta në ambient, etj., si të Drejta të gjeneratës së tretë edhe në Kosovë janë në fazën e kalimit nga niveli i debatit për t'u shndërruar në nocione praktike, kurse diskriminimi pozitiv në rrethanat e zhvillimeve aktuale politike herë herë merr përmasa që duke tejkaluar fushën e të drejtave të njeriut, mund të rrezikojë edhe qenësinë e shtetit të Kosovës.

Punimi ka për qëllim që duke analizuar kapitullin e dytë të Kushtetutës së Kosovës lidhur me të Drejtat e njeriut të vë në pah kornizën aktuale formalo juridike dhe mangësitë ekzistuese të të drejtave të gjeneratës së tretë. Punimi do të vë në pah edhe formën dhe nivelin e diskriminimit pozitiv që përdoret në Kosovë në kontekst të tejkalimit praktik të kornizave që janë të njohura në botë lidhur me këtë çështje. Në mënyrë të pashmangshme punimi do të nxjerrë rekomandime që mund të përdoren nga teoria dhe praktika në Kosovë.

Fjalët kyçe: Të drejtat, Konventat, Kushtetuta, diskriminimi pozitiv, gjenerata e tretë.

---

<sup>1</sup> Dr.sc. Universiteti i Prishtinës

<sup>2</sup> Phd Can

<sup>3</sup> Dr.sc. Kolegji AAB



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

341(496.51)(063)

343.98(496.51)(063)

Libri i Abstraktëve / Kolegji AAB . – Prishtinë : Kolegji AAB,  
2015. – 60 f., 46 f. ; 21 cm.

Në anën e kundërt të librit titulli dhe teksti paralel në gjuhën angleze

**ISBN 978-9951-494-54-0**